



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

BASIC EDUCATION PROGRAM

RENOVIMI I KLASAVE



DEKLARATË MOHIMI

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

DEKLARATA NGA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Planin Strategjik për Arsim 2011 - 2016 një rëndësi të madhe i kushton përmirësimit të cilësisë së arsimit. Prandaj, ne i mirëpresim veprimet e ndërmarra nga Basic Education Program, program i financuar nga USAID dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, për përmirësimin e cilësisë së ambientit mësimor për nxënësit e shkollave të arsimit të obliguar.


Veçanërisht mirëpresim angazhimin aktiv të mësimitdhënësve, prindërve, drejtorëve të shkollave, komunitetit dhe biznesit vendor në renovimin e këtyre klasave. Decentralizimi nuk është vetëm proces administrativ; ai ka të bëjë me bartjen e fuqisë dhe vendimmarrjes tek komuniteti shkollor. Kjo është arsyeja që MASHT-i i fuqizon këshillat drejtuese të shkollave me fuqi dhe përgjegjësi shtesë.

Ky libër ofron këshilla dhe frymëzim për këshillat drejtuese të shkollave, mësimitdhënësit dhe prindërit të cilët dëshirojnë të krijojnë mjedis më të mirë mësimi për fëmijët e tyre. Poashtu, ky libër i njofton ata me disa qasje të mësimitdhënies dhe të nxënies të cilat parashtrohen në Kornizën e re të Kurrikulës së Kosovës. Basic Education Program dhe iniciativat e tjera nga MASHT-i do të ofrojnë një sërë kursesh trajnuese për mësimitdhënësit për t'i përkrahur ata në zbatimin e këtyre qasjeve gjatë viteve në vazhdim. Basic Education Program, poashtu, do të ofrojë trajnime për këshillat drejtuese të shkollave.

Urojmë mësimitdhënësit, prindërit dhe drejtorët e shkollave për punën e bërë, të paraqitur në këtë libër dhe presim me padurim renovimin e shumë klasave tjera gjatë muajve dhe viteve në vazhdim.

Me respekt,

Nehat Mustafa, Zëvendësministër



Basic Education Program (Programi për Arsimin Themelor) është një iniciativë pesëvjeçare e dizajnuar për t'i kontribuar të gjitha shkollave publike fillore dhe të mesme të ulëta në Kosovë, (klasave 1 – 9). Kjo iniciativë është e bashkë-financuar nga USAID dhe Qeveria e Kosovës. Motoja e Basic Education Program është:

“Zhvillimi i shkathtësive të shekullit 21 tek nxënësit në patneritet me shkollën dhe komunitetin”.

Kështu, *Basic Education Program* synon të ngrit kapacitetin e shkollave të Kosovës për t'i zhvilluar shkathtësitë relevante të nxënësve. Qëllimi i saj kryesor është ta përmirësojë kapacitetin institucional të Qeverisë së Kosovës në sektorin e arsimit dhe ta përmirësojë cilësinë e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët.

Basic Education Program i përfshin tri komponentet në vijim:

1. Ngritja e kapaciteteve menaxhuese të shkollave në mjedis të decentralizuar;
2. Përmirësimi i vlerësimit të rezultateve të të nxënësit;
3. Përmirësimi i ngritjes profesionale të mësimit në mënyrë pa shkëputje nga puna.

FHI D360 është duke e zbatuar Basic Education Program në emër të USAID-it në partneritet me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC). KEC-i është i nënkontraktuar për ta menaxhuar Komponenten 3: Përmirësimi i ngritjes profesionale të mësimit në mënyrë pa shkëputje nga puna.

DEKLARATA NGA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCË DHE TEKNOLOGJISË

MIRËSEARDHJE (HYRJE)

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM MJEDISI MËSIMOR?

TË NXËNIT AKTIV

PËRFSHIRJA E KOMUNITETIT

KRYERJA E PUNËVE

KRIJIMI I MATERIALEVE PËR MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE

RREGULLIMI I KLASAVE 1 – 5

QENDRA E LEXIMIT DHE SHKRIMIT

QENDRA E MATEMATIKËS

QENDRA E SHKENCËS

PËRDORIMI I TIK-ut (Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit) NË KLASË

RREGULLIMI I KLASAVE TË PËRQENDRUARA NË FUSHA TË CAKTUARA

KLASA E PËRQENDRUAR NË TEKNOLOGJI

KLASA E PËRQENDRUAR NË SHKENCË

SHTOJCAT

Shtojca A: Kurset e organizuara nga Basic Education Program

Shtojca B: Referencat dhe Kërkimet e Mëtejme

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Ju lutemi ta vizitoni web-faqen tonë www.bep-ks.org për më shumë informata për Basic Education Program të USAID-it dhe për renovimet e klasave. Në web-faqe po ashtu do t'i gjeni gjashtë programet televizive të realizuara nga RTK-ja.



... nga Basic Education Program i USAID-it dhe Ekipi ynë i Renovimit të Klasave.

Ky libër është për të gjithë ata që janë të interesuar për përmirësimin e klasës në mënyrë që nxënësit të jenë më të lumtur, të ndjehen më rehat dhe të mësojnë më mirë.

Ne e kemi planifikuar aktivitetin tonë të renovimit të klasëve për të:

- ngritur vetëdijen për nevojën e përmirësimit të mjedisit mësimor në klasat e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të Kosovës
- demonstruar se si shkollat, prindërit dhe komuniteti lokal mund ta bëjnë këtë; dhe
- ofruar këshilla praktike për mënyrat se si të bëhen klasat mjedise mësimore më efektive me një kosto më të ulët.

Transmetuesi kombëtar - RTK, i ka realizuar gjashtë programe televizive të cilat i tregojnë aktivitetet tona të renovimit në gjashtë shkolla të ndryshme. Ky libër përmban shembuj nga këto programe televizive, por gjithashtu përmban edhe ide plotësuese nga ekspertët tonë vendor dhe ndërkombëtarë.

Për çka shërben ky libër?



A është në rregull nëse e ndryshojmë klasën? Çfarë thotë ligji?



PO! MUND TA BËNI

Në përputhje me ligjin, shkollat kanë të drejtë të mbledhin fonde për t'i mbështetur përmirësimet në shkollë dhe përmirësimet në arsim në përgjithësi. Ligji i ri për arsimin para-universitar (Nr.04/L-032), Neni 17, i specifikon detyrat dhe kompetencat e këshillit drejtues të shkollës. Në bazë të Nenit 17, pika 11.4, këshilli drejtues i shkollës vendos për përdorimin e fondeve që i janë dhënë shkollës si kontribute nga prindërit dhe donatorët tjerë. Kontributet mund të jenë financiare dhe jo-financiare, kështu që shkolla duhet t'i hetojë burimet lokale të cilat mund t'i shfrytëzojnë.

Për të mbledhur fonde plotësuese për buxhetin e tyre, disa shkolla në Kosovë janë duke i lëshuar me qera objektet e tyre përcjellëse, siç janë sallat sportive, kabinetet e kompjuterëve, sallat e ushqimit, etj. Ky buxhet shfrytëzohet nga shkolla, me miratimin e këshillit drejtues të shkollës, për ta mbështetur zbatimin e planit vjetor të shkollës.

Për t'u siguruar që shkolla vepron në përputhshmëri me ligjet ekzistuese në Kosovë, këshilli drejtues i shkollës duhet t'i miratojë aktivitetet e tilla.

Koment i një mësimsdhënësi.

"Është klasa e njëjtë e mua po më duket sikurse jam në një shtet tjetër!"

A mund ta bëjmë këtë vetëm, pa ndihmën e dikujt tjetër?



PO! MUND TA BËNI

Në qershor, shkolla fillore e mesme e ulët "Naim Frashëri", në Vushtrri, ishte shkolla e parë në Kosovë e cila përfitoi nga aktiviteti për Renovimin e Klasës nga Basic Education Program i USAID-it. Një klasë u renovua si shembull i asaj se si prindërit dhe komuniteti lokal mund të organizohen për ta përmirësuar mjedisin mësimor përbrenda klasës. Që atëherë, për pesë muaj radhazi, shkolla ka vazhduar të punojë me prindërit dhe komunitetin për t'i "renovuar" të gjitha klasat tjera në shkollë. Një video-film për këtë iniciativë të shkollës në Vushtrri është i disponueshëm në web-faqen e Basic Education Program.

Kur Basic Education Program e filmoi programin televiziv të "renovimit të klasës" në shkollën fillore të mesme të ulët "Lidhja e Prizrenit", në Deçan në shtator 2011, u planifikua që ky të ishte një shembull për të demonstruar se si prindërit dhe komuniteti mund të bashkohen dhe ta krijojnë një mjedis më të mirë mësimor për fëmijët e tyre. Pjesëtarët e programit nuk e pritën një ndikim aq të menjëhershëm të "renovimit". Pas "renovimit", drejtori dhe mësimsdhënësit në shkollën "Lidhja e Prizrenit", i ftuan prindërit tjerë për ta vizituar klasën e renovuar me mbështetjen e dhënë nga Programi. Si rezultat, u renovuan edhe dhjetë klasa më shumë bashkë me përfshirjen e prindërve dhe komunitetit. Drejtori i shkollës dhe mësimsdhënësit siguruan edhe drekë për grupet punuese të prindërve dhe po ashtu u kyçën në mënyrë të drejtpërdrejt në aktivitetin e renovimit të klasës.

Koment i një prindi.

"Kurrë nuk më ka shkuar mendja se vetëm gjatë një jave do të mund ta bënim një ndryshim kaq mahnitës. Mezi po pres ta shoh fytyrën e djalit tim kur të hyjë në klasë"

Para & Pas

Klasa 1-5, Malishevë



Klasa e përqendruar në Teknologji, Deçan



Klasa 1-5, Gjakovë



Para & Pas

Klasa 1-5, Klllokot



Klasa e përqendruar në Shkencë, Ferizaj



Klasa 1-5, Prishtinë



PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM MJEDISI MËSIMOR?

Ne të gjithë punojmë më mirë kur mjedisi ynë i punës është më tërheqës. E njëjta vlen edhe për mësimdhënësit dhe nxënësit. Atëherë pse duhet të gjitha klasat të duken të njëjta? Shkollat janë vende ku mësohet, jo burgje! Ato duhet të jenë të rehatshme dhe mike-për-fëmijë kështu që nxënësit të ndjehen të lumtur dhe të motivuar për të nxënë. Në cilën nga këto klasë do të dëshironit ju që fëmijët tuaj ta kalonin ditën?



Dizajni i hapësirës së brendshme duhet të jetë qëllimplotë dhe i planifikuar me shumë kujdes. Klasët që janë tërheqëse dhe të rehatshme u ndihmojnë fëmijëve dhe mësimdhënësve të ndjehen mirë. Rregullimi i orendive duhet të mundësojë të nxënit aktiv, aktivitete praktike dhe punë në grupe. Ta mësosh një fëmijë se si të mësojë, më shumë se sa çfarë të mësojë, dhe t'ia mundësosh secilit fëmijë ta zhvillojë potencialin e vet, të zgjidhë probleme komplekse dhe të dizajnojë teknika më efektive për përmbushjen e punës së vet janë shkathtësi shumë të rëndësishme në shekullin 21. Natyrisht, njohuritë elementare janë të rëndësishme për nxënësit për të kuptuar, por të kuptuarit e thellë, konceptual—njohuritë që zgjasin janë më të rëndësishme.


Çka nëse kam shumë nxënës në klasë?



Duke i ulur fëmijët në grupe dhe duke i rregulluar tavolinat rreth skajeve të klasës ju mund të krijoni më shumë hapësirë për punë dhe për të lëvizur.

Shikoni planet e klasave më poshtë.

Në rregullimin e parë tradicional, janë 16 tavolina dhe vende për 32 nxënës. Por në rregullimin e dytë, janë 22 tavolina dhe ka hapësirë për aktivitete praktike dhe për punë në grupe deri në 40 nxënës.



Altin Selmani, një nxënës i klasës së 5-të në shkollën "Gjergj Fishta", shkroi për klasën e tij të re:

"Me ndihmën e USAID-it, klasa jonë u bë klasa më e bukur në shkollë. Ka shumë dallime në krahasim me klasën e "vjetër", pikë së pari: Biblioteka apo këndi i leximit ku ne mund ta pasurojmë fjalorin tonë; këndi i TI (Teknologjisë së Informimit) i cili ka edhe laptop të cilët mund të na ndihmojnë në kërkimet tona dhe në mësimin e gjërave të reja; këndi i Matematikës ku ne mund t'i zhvillojmë mësimet në Matematikë në një formë shumë më të mirë dhe mund t'i kuptojmë gjërat më mirë; dhe këndin e Artit ku mund të vizatojmë dhe të pikturojmë. Ky është një përshkrim i shkurtër i klasës sime të mrekullueshme dhe unë jam shumë i lumtur që ne mund të mësojmë në një klasë të tillë."

Pse mos t'i vendos tavolinat në radhë?



Siç e keni parë në faqen paraprake, vendosja e tavolinave në radhë mund të zërë më shumë hapësirë. Kjo po ashtu mund t'i kufizojë aktivitetet praktike dhe diskutimet në grupe. Nëse përdorni pajisje elektrike siç janë kompjuterët, atëherë ata duhet të jenë të mbështetur për muri në mënyrë që nxënësit të mos zënë nëpër kablo elektrike.

Një mjedis mësimor i dizajnuar mirë dhe fleksibil mbështet një aktivitet kompleks, pavarësi, socializim dhe zgjidhje të problemeve. Fëmijët ndjehen të ngazëlyer dhe të detyruar që ta fillojnë mësimin, të hulumtojnë materiale dhe të zbulojnë informata të reja.



A nevojiten rregullime të ndryshme për moshat të ndryshme?



Nxënësit e të gjitha moshave duhet të jenë aktiv gjatë të nxënit në mënyrë që ta zhvillojnë shkathtësinë e të nxënit në mënyrë të pavarur dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë e punës së shekullit 21. Pra, rregullimi i tavolinave në grupe është i përshtatshëm për të gjithë nxënësit. Tabelat e ekspozimit janë të rëndësishme në të gjitha klasat në mënyrë që mësimdhënësit të jenë në gjendje të varin mjete ndihmëse vizuale dhe t'i shfaqin punimet e nxënësve. Qasja në kompjuterë është e rëndësishme për të gjitha moshat.

Megjithatë, moshat e ndryshme kanë nevoja të ndryshme. Derisa këndi i leximit dhe shkrimit ku fëmijët mund të mësojnë të lexojnë në qetësi dhe të kënaqen me libra është i rëndësishëm për fëmijët e vegjël, nxënësit më të rritur mund të preferojnë më shumë që të ulen para kompjuterit dhe të bëjnë hulumtime për vete. Fëmijët më të vegjël janë të kënaqur kur ulen poshtë në dysheme për të diskutuar, kurse nxënësit më të rritur preferojnë të ulen rreth tavolinës. Për klasat 6 – 9, ka nevojë edhe për klasë të përqendruara në fusha të caktuara në mënyrë që nxënësit të kenë teknologji të përshtatshme arsimore për lëndën përkatëse. Për shembull, nxënësit kanë nevojë për pajisje të ndryshme për shkencë, teknologji dhe gjuhë. Nxënësit më të vegjël mund t'i pëlqejnë ngjyrat bazike dhe më të ndritshme, por adoleshentët do t'i preferojnë ngjyrat më të "buta" me një pamje moderne.

Blend Behluli, nxënës i klasës së 5-të, Shkolla "Gjergj Fishta".

"Kushtet e mira të mësimin dhe një klasë e kompletuar me një inventar të qëlluar na motivojnë të mësojmë."

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Shihni faqen 22 Rregullimi i Klasave 1-5 dhe faqen 42 Rregullimi i Klasave të Përqendruara në fusha të caktuara.

Të nxënët aktiv do të thotë kur nxënësit punojnë detyra të cilat ata i kuptojnë dhe u duken të rëndësishme. Është shumë më efektiv se sa të ligjëruarit tradicional, sepse nxënësit e angazhuar e përvetësojnë të nxënët.

Një proverbë e vjetër kineze thotë:
Dëgjoj ... harroj
Shoh ... mbaj në mend
Bëj ... kuptoj

Ne mësojmë më mirë kur bëjmë diçka praktike. Mund të lexojmë se si duhet të ngitet automobili ose të ulemi me dikë që do të na tregojë çfarë të bëjmë. Por, në të vërtetë, vetëm kur e ngasim atë vet mund të mësojmë se si bëhet një gjë e tillë.

Përfitimet nga të Nxënët Aktiv

Ua mundëson të gjithë fëmijëve që të mësojnë si të rritur:

- Të bëjnë përmbledhje si hulumtues të vërtetë;
- Të studiojnë formula dhe relacione si matematikanë të vërtetë;
- Të bëjnë eksperimente si shkencëtarë të vërtetë;
- T'i përpilojnë vet raportet dhe videot e veta si gazetarë të vërtetë;
- T'i shkruajnë vet poezitë dhe tregimet e veta si autorë të vërtetë;
- T'i përdorin kalkulatorët dhe kompjuterët si punonjës të vërtetë;
- Të jenë kreativ si artistët; dhe
- Të jenë plot me risi si ndërmarrësit.

Kjo ua mundëson të gjithë nxënësve të punojnë në formë të bashkëpunimit, të bëjnë zbulime dhe të ndjehen krenarë me punën e tyre. Kjo ua mundëson të gjithë nxënësve që të kontribuojnë për një klasë tërheqëse dhe një ambient shkollor tërheqës.

Kjo e vë në pah rëndësinë e punës shkollore në jetën e të gjithë nxënësve. Kjo i largon pengesat në të nxënë, siç janë mungesa e shkathtësive të lexim-shkrimit, kështu nxënësit me nevoja të veçanta mund të marrin pjesë si të barabartë.



Çfarë nuk shkon me mënyrën e vjetër të mësimdhënies?



Nga klasat me mësimdhënësin në qendër në ato me nxënësin në qendër
Një mësimdhënës që u ndihmon nxënësve të hulumtojnë dhe të zbulojnë vet është shumë më efektiv se sa një mësimdhënës që vetëm u tregon nxënësve çdo gjë.

Mësimdhënia tradicionale ishte krijuar për ta pasqyruar vendin e punës të shekullit të nëntëm-bëdhjetë, ku nëpunësit uleshin në tavolinat e tyre në radhë, dhe punëtorët në prodhim qëndronin në radhë para makinave të tyre.

Ne jemi duke jetuar në shekullin 21, ku vendet e punës janë shumë më komplekse dhe njerëzit punojnë në grupe, përdorin kompjuterin në vend të lapsave. Sot, punëdhënësit ankohen se duhet t'ia riaftësojnë nxënësit për shkathtësitë moderne të forcës punëtore.

Shkollat duhet të ndryshojnë për t'u përshtatur me këtë botë të re. Korniza Kurrikulare e re e Kosovës vë theks mbi kompetencat e përjetshme të cilat nxënësit do t'i mësojnë në shkollë, më mirë se sa njohuritë të cilat me siguri do t'i harrojnë kur ta përfundojnë shkollimin.

Por, a nuk duhet t'u shpjegohen gjërat nxënësve nga mësimdhënësit?



Po ata e bëjnë këtë, por jo gjatë tërë orës së mësimit!

Kur mësimdhënësi duhet të bisedojë me tërë klasën, nxënësit duhet t'i kthejnë karriget e tyre përballë me mësimdhënësin dhe të dëgjojnë, por shpjegimet janë shpesh më efektive nëse ofrohen në grupe të vogla pasi që nxënësit e dalluar i kuptojnë ato më shpejt, ndërsa të tjerëve u duhet më shumë kohë dhe shpjegime.



Nxënësit e mi më parë nuk kanë punuar në grupe. Ata nuk mund të punojnë të pavarur.



Nxënësit kurrë nuk do t'i zhvillojnë shkathtësitë e të mësuarit të pavarur, nëse atyre nuk u ofrohet mundësia për ta provuar këtë.

Do të duhet të pajtoheni me nxënësit për rregulla të qarta në mënyrë që ata ta kuptojnë se duhet të jenë të durueshëm, t'i ndajnë gjërat dhe t'i ndihmojnë njëri-tjetrit. Lejoni që ata vet të hartojnë një listë rregullash si një ushtrim gjuhësor. Për shembull mënyra se si lëvizin nëpër klasë, se si i përdorin pajisjet, se si flasin me njëri-tjetrin. Krijoni sinjale të cilat ua bëjnë nxënësve me dije kur ata janë duke bërë shumë zhurmë.

Klasa juaj duhet të jetë e organizuar me kujdes. Sigurohuni që çdo gjë që u nevojitet nxënësve të jetë në dispozicionin e tyre dhe ata ta dinë se ku mund t'i gjejnë ato. Përfshirja e nxënësve në organizimin e gjërave do t'i ndihmojë mësimdhënësit por gjithashtu do t'u ndihmojë edhe nxënësve.

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Basic Education Program i USAID-it është duke organizuar kurse për mësimdhënësit e shkollave fillore të mesme të ulëta të cilët do t'i renovojnë klasat. Programi gjithashtu organizon kurse rreth Vlerësimit për të Nxënët për të gjithë mësimdhënësit e arsimit fillor të mesëm të ulët. Këto do t'ju ndihmojnë rreth organizimit të klasave tuaja dhe orëve tuaja të mësimit. Për më tepër informata rreth kurseve të organizuara nga Basic Education Program shih Shtojcën A në fund të këtij libri.


BASHKËPUNIMI MËSIMDHËNËS-FAMILJE

Të punuarit së bashku në renovimin e klasës do t'i forcojë marrëdhëniet në mes të familjes dhe shkollës. Partneritetet e forta ndërmjet mësimitdhënësve, familjeve dhe anëtarëve tjerë të komunitetit janë thelbësore për nxënien dhe zhvillimin e fëmijëve. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes së ngushtë janë njerëzit më të rëndësishëm në jetën e një fëmije. Ata janë të përfshirë në të nxënien dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre qysh nga lindja e fëmijës.

Ata e sigurojnë themelin kulturor dhe sistemin e vlerave rreth së cilave përqendrohet procesi i socializimit të fëmijës. Kur shkollat, familjet dhe grupet e komunitetit punojnë së bashku në mbështetje të të nxënien, fëmijët kanë tendencë që të arrijnë sukses më të mirë në shkollë, të qëndrojnë në shkollë më gjatë dhe ta pëlqejnë shkollën më tepër.

Ndjeshmëria dhe reagimi i mësimitdhënësve ndaj familjeve është demonstruar përmes vlerësimit të mënyrave të shumta përmes së cilave familjet mund të kontribuojnë në të nxënien e fëmijëve të tyre, në jetën e klasës dhe atë të shkollës.

Një lidhje e mirë midis fëmijës, familjes dhe shkollës është një faktor thelbësor në sigurimin e suksesit në shkollë.



Këshilli drejtues i shkollës

Basic Education Program ka zhvilluar një program trajnimi për këshillat drejtues të shkollave bazuar në detyrat dhe kompetencat e tyre. Duke e ditur se roli i këshillit drejtues të shkollës për mbikëqyrjen financiare mbetet shumë i kufizuar për shkak të buxhetit të ulët, ne ofrojmë ushtrime rreth asaj se si do të vendoste një këshill drejtues shkollor për shfrytëzimin e fondeve shtesë të ofruara nga donatorët e tjerë dhe prindërit.

Me qëllim që komuniteti i shkollës t'i mbështesë përmirësimet në shkollë, aktivitetet për mbledhjen e fondeve janë të inkurajuar nga autoritetet qendrore dhe ato lokale arsimore. Ligji i ri për arsimin parauniversitar (Nr.04/L-032), neni 17, përcakton detyrat dhe kompetencat e këshillit drejtues të shkollës. Sipas nenit 17, pika 11.4, këshilli drejtues i shkollës vendosë për shfrytëzimin e fondeve që i janë dhënë shkollës si kontribut nga prindërit ose donatorët e tjerë.

Edhe pse nuk duhet të pritët nga prindërit që të paguajnë për arsimimin e fëmijëve të tyre, ata mund dhe duhet t'i mbështesin shkollat e tyre në mënyra praktike. Prindërit dhe anëtarët e komunitetit kanë aftësi dhe mundësi të ndryshme të cilat mund të shfrytëzohen nga shkolla. Për shembull një prind shet ngjyra, tjetri di të ngjyros muret, ose një prej tyre është zdrukthëtar dhe tjetri është dizajner.

Përpjekjet e tilla dhe të tjera mund të kombinohen mirë për ta siguruar mbështetjen e nevojshme për transformimin e një klase tradicionale në një ambient bashkëkohor dhe tërheqës të të nxënien. **Këshilli i Prindërve** gjithashtu është një organ i cili mund të ndihmojë rreth organizimit të aktiviteteve të renovimit të klasës.

Dëshironi të mësoni më shumë për rolin e këshillit drejtues të shkollës apo rreth trajnimit të këtij këshilli? Shikoni një listë të kurseve në shtojcën A në fund të këtij libri, ose kontaktoni Basic Education Program të USAID-it: BEPinfo@fhi360.org

PLANIFIKIMI I PUNËS SË BASHKU

Hapi i parë për renovimin e klasës është identifikimi i nevojave dhe prioriteteve. Mësimitdhënësi është përgjegjës profesional për rregullimin e klasës. Duke e planifikuar rregullimin e klasës dhe krijimin e qendrave të të nxënien, mësimitdhënësit duhet të mendojnë edhe për llojin e hapësirës që kërkohet dhe mënyrën se si të përfshihen prindërit dhe fëmijët në krijimin e mjedisit mësimor. Në renovimet tona, së pari u takuan profesionistët për të vendosur se çfarë duhet të bëhet para se t'i ftonin prindërit.

Por edhe përfaqësues të prindërve nga këshilli drejtues i shkollës dhe këshilli i prindërve mund të përfshihen në këtë proces. T'i kontrollojnë dritaret, dyshemetë, sipërfaqet e tavolinave, karriget, muret, dërrasat e zeza, a ka nevojë klasa për rafte, dollape apo tabela ekspozimi ku mund të paraqitet puna e nxënësve.

Burimet e shkollës.

Diskutoni me drejtorin e shkollës në lidhje me renovimin e klasës dhe pyeteni nëse shkolla mund të ndihmojë financiarisht ose nëse shkolla mund ta mbështesë këtë iniciativë me ekip teknik për ngjyrosje apo ndonjë punë tjetër gjatë renovimit të klasës. Komuna gjithashtu mund të ofrojë një pjesë të ndihmës, për shembull ndihmë teknike dhe këshilla.



Organizimi i takimit me prindër.

Në këtë takim përfaqësuesit e mësimitdhënësve dhe prindërve të klasës mund ta paraqesin iniciativën para prindërve dhe anëtarëve tjerë të familjes. Gjyshërit shpesh kanë më shumë kohë dhe disa prej tyre i kemi parë si punëtorët më të zellshëm gjatë renovimeve tona. Gjatë prezantimit ju mund t'i përdorni videot nga www.bep-ks.com ku mund t'i shkarkoni gjashtë programet televizive për renovimin e klasave. Tregojani këtë libër prindërve në takimin e prindërve. Diskutoni me prindërit në lidhje me burimet financiare dhe fizike. Kush mund të dhurojë të holla? Kush mund të ndihmojë fizikisht gjatë procesit të renovimit? A di të ngjyros ndonjë nga prindërit? A nje ndonjëri ndonjë kompani që do ta dhuronte ngjyrën?

Krijoni një bazë të të dhënave ose një listë që tregon

- cilët prindër duan të ndihmojnë,
- çka mund të kontribuojnë ata, dhe
- kur janë ata në dispozicion.

A ekziston ndonjë biznes lokal i cili do ta mbështeste projektin. Nëse nuk mund t'i gjeni të gjitha burimet për atë që ju dëshironi të bëni, të paktën fillojani. Planifikoni punën në faza, bazuar në prioritetet tuaja.

Formoni grupe të punës nga ata prindër që janë të gatshëm për të ndihmuar.

KËSHILLA KRYESORE

Përfshini edhe anëtarët e tjerë të familjes sikurse edhe prindërit. Gjyshërit shpesh kanë më shumë kohë dhe disa prej tyre i kemi parë si punëtorët më të zellshëm gjatë renovimeve tona.

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Ju lutemi shikoni shtojcën B për planifikimin dhe delegimin e përgjegjësisë në faqen 54.

PËRFSHIRJA E BIZNESEVE LOKALE NË RENOVIMIN E KLASËS

Ndërkohë që sigurohemi që t'i përfshijmë prindërit dhe mësime të rinjësit në renovim, duhet t'i përfshijmë edhe bizneset lokale. Ato mund ta bëjnë gjithë procesin më të lehtë pasi që kanë njohuri profesionale (për shembull rreth llojit më të mirë të ngjyrës e cila do të përdoret për qëllime të ndryshme). Edhe në qoftë se ato nuk mund të ofrojnë donacione, mund të jenë të gatshme që të ofrojnë zbritje bujare. Në renovimet tona kemi pranuar donacione të ngjyrës për mur, tavolina dhe karrige; për perde, tepihë ose linoleum; për ndriçim etj. Një kompani na dhuroi tullat për ta ndërtuar një mur ndarës.



Marrja e donacioneve

Nga ekipi juaj i mësime të rinjësitve, prindërve dhe ndihmësve, identifikoni njerëzit më bindës për të dalur dhe biseduar me bizneset. Disa njerëz mund të kenë miq apo të afërm që kanë biznese. Pastaj, përpiloni një listë të bizneseve dhe caktoni vizitat. Merrni një kopje të këtij libri me vete për t'ju ndihmuar që ta shpjegoni konceptin. Ata duhet ta kuptojnë rëndësinë e një renovimi të klasës për fëmijët e asaj klase dhe për komunitetin. Ju gjithashtu mund t'i ftoni donatorët e mundshëm për t'i parë disa nga programet televizive në qoftë se ata nuk i kanë parë ato deri atëherë. Bizneset mund të ketë motive të ndryshme për të qenë donatorë:

- Mund t'i kenë fëmijët ose të afërmit e tyre që ndjekin mësimet në atë shkollë;
- Mund të jenë altruistë dhe të kenë dëshirë t'i ndihmojnë fëmijët e komunitetit;
- Mund të jenë patriot dhe të kenë dëshirë ta ndihmojnë ndërtimin e kombit;
- Dëshirojnë ta kenë një reputacion të mirë brenda komunitetit në mënyrë që biznesi i tyre të përparojë; dhe
- E dinë se shkolla do ta publikojë donacionin e tyre, kështu që kjo do të ishte reklamë e mirë.

Kur shkoni për të kërkuar donacione duhet ta merrni parasysh idenë e ekzistimit të një dokumenti identifikues, siç është një letër nga drejtori i shkollës.



Përkujdesuni që të theksoni se është në bazë të vullnetit të tyre se sa do të dhurojnë ose nëse ata fare do të dhurojnë. Në qoftë se ai biznes shet gjëra që ju nevojiten, ata ose mund t'ju japin tërë sasinë që ju nevojitet, një pjesë të saj, ose t'ju shesin atë me një zbritje. Mundohuni ta lëni mundësinë e blerjes së produkteve të tyre me një zbritje si opsion të fundit, kur e shihni se personi nuk është i gatshëm për të dhuruar.

KËSHILLA KRYESORE

BUZËQESHNI! ...dhe falënderoni donatorët e mundshëm për kohën e tyre edhe nëse nuk jeni të suksesshëm. Kurrë nuk mund ta dimë se a do ta ndryshojnë mendjen në të ardhmen.



Një mënyrë tjetër për të përfituar donacione, përpos nga bizneset që shesin produktet që ju nevojiten, është që t'i kërkonit donatorët potencial prej të cilëve mund të kërkonit një shumë parash si donacion dhe t'ju dërgoni atyre më pas faturën e gjërave të blera me ato para si një dëshmi që paratë e tyre nuk janë keqpërdorur.

Disa biznese mund të mos jenë në gjendje që t'ju ofrojnë materiale, por mund të jenë të gatshëm t'ju ndihmojnë me këshilla profesionale ose shkathtësi të specializuara, të tilla si projektues, elektrikistë, zdrukthëtarë, fasadues apo mjeshtër të tjerë. Ata gjithashtu mund të jenë të gatshëm t'ju huazojnë pajisjet për t'i lehtësuar punimet, siç janë veglat, spërkatësit e ngjyrës, makinat për prerjen e drurit, makinat për gërryerjen e dyshemesë, etj.

Nxënësit mund të shkruajnë dhe të dekorojnë "letra falënderuese" për të gjithë personat që ju ndihmuan gjatë procesit, qoftë fizikisht ose duke dhuruar gjëra/të holla. Një "letër zyrtare falënderuese" nga drejtori i shkollës gjithashtu do të pritej me mirënjohje nga donatorët.

Ftoni donatorët në ceremoninë e hapjes së klasës së renovuar në mënyrë që të kenë mundësinë të shohin se si është përdorur donacioni i tyre dhe që t'i pranojnë falënderimet nga nxënësit.

Basic Education Program dëshiron t'i falënderojë donatorët në vijim të cilët ofruan mbështetje për projektet e renovimit të klasave:

Afrimi AG, Deçan
Gogaj AG, Deçan
Monte Toni, Deçan
Tropikal, Deçan
Drejtorja Komonale e Arsimit, Gjakovë
DPZ "Liria", Gjakovë
DPZ "Sadik Aga", Gjakovë
Libraria "Nobeli", Gjakovë

Bereqeti, Malishevë
Drejtorja Komonale e Arsimit, Ferizaj
Bavaria, Ferizaj
Bledi Color, Shtime
A & A, Prishtinë
Amper, Prishtinë
Alberti Paint Factory, Prishtinë
Baholli Colors, Prishtinë
Comtrade Computers, Prishtinë

DPT "Toni", Prishtinë
Elektro AG, Prishtinë
Euroroleta, Prishtinë
Gjini Carpet, Prishtinë
Migros, Prishtinë
NTP "Kromos", Prishtinë
OMC Company, Prishtinë
Përparimi, Prishtinë
Standard SHPK, Prishtinë

KRYERJA E PUNËVE: ORENDITË



Riciklimi i orendive të vjetra

Kemi blerë materiale për sipërfaqet e sipërme të tavolinave dhe për tabelat e ekspozimit, por nuk kemi blerë orendi të reja gjatë renovimeve të klasave. Në vend të kësaj, kemi marrë orendi të vjetra dhe i kemi renovuar ose ricikluar.



Renovimi i tavolinave të vjetra të nxënësve

Sipërfaqet e sipërme të reja të tavolinave ndoshta janë gjëja më e rëndësishme që kemi blerë. Gjatë renovimeve tona kemi përdorur kompensatë (shpërplakë) të petëzuar. Ju mund ose t'i ngjyrosni skajet ose t'i mveshni ato me shirit plastik.

Sipërfaqet e sipërme të vjetra të tavolinave janë shkurtuar dhe janë bërë raftet dhe dollapët. Pastaj sipërfaqet e reja të tavolinave u janë bashkangjitur skeleteve metalike (këmbëve) ekzistuese të tavolinave. Shtimi i sipërfaqeve të rrumbullakëta ose katrore do të thotë se një tavolinë për dy nxënës tani mund të përdoret edhe për katër sish.




KËSHILLA KRYESORE

Shfrytëzoni sipërfaqet e sipërme të vjetra të tavolinave për t'i bërë raftet që do të shfrytëzohen për ruajtje dhe ekspozim të punimeve.



FORMA E TAVOLINAVE TË PUNËS

- Tavolinat nuk duhet patjetër të jenë drejtkëndëshe, por, nëse ato janë të tilla, atëherë njëra tavolinë duhet ta ketë gjatësinë sa gjerësia e dy tavolinave tjera të vendosura pranë njëra-tjetrës. Kjo ua mundëson atyre që të vendosen së bashku për të formuar grupe me më shumë se katër nxënës.
- Tavolinat drejtkëndëshe janë më të mira për vendosjen përballë murit (p.sh. si këndi i kompjuterit).
- Tavolinat në formë trapezoidi ua mundësojnë tre nxënësve që të punojnë së bashku. Dy sosh mund të vendosen së bashku për ta bërë një grup prej gjashtë nxënësish.
- Tavolinat rrethore dhe gjysmë-rrethore ofrojnë më shumë mundësi për lëvizje në klasë.



KËSHILLA KRYESORE

Nëse nuk keni skelete metalike (këmbë) bankash të mjaftueshme, atëherë vendosni sipërfaqe të sipërme katrore ose të rrumbullakëta në mënyrë që rreth tyre të mund të ulen sa më shumë nxënës.

KARRIGET

Ndërkohë që orenditë ishin duke u punuar, anëtarët e tjerë të ekipit të renovimit e bënë ngjyrosjen e karrigeve. Para ngjyrosjes së karrigeve, kontrolloni ato dhe kryeni riparimet e nevojshme.

Ngjyrosja e karrigeve është një nga punët që merr më shumë kohë, kështu që patëm nevojë për tërë ndihmën që arritëm ta gjenim dhe u përkujdesëm që çdo gjë të ishte e organizuar mirë. Ofruam dorëza plastike për të mos pasur nevojë për pastrim të tepërt të duarve.



KËSHILLA KRYESORE

Duhet mjaft kohë që karriget të thahen para se të uleni në to ... dhe vishni rroba të vjetra gjatë ngjyrosjes!

TABELAT PËR EKSPOZIM

Ne kemi përdorur kompensatë (shpërplakë) druri me korniza për tabelat e ekspozimit. Stiroperi është mbërthyer në tabelat për ekspozim dhe është mbuluar me pëlhurë të hollë të depërtueshme në mënyrë që gjilpërat të mund të futen më lehtë në të. Nëse mund të gjeni material tape që ta vendosni në tabela, kjo do të ishte zgjidhja më e mirë. Tabelat për ekspozim kishin dy madhësi: 150 cm x 100 cm dhe 100 cm x 100 cm.

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Lexoni më shumë rreth asaj se si të krijoni tabela ekspozimi më efektive, në faqen 43.



PËRZGJEDHJA E NGJYRAVE

Planifikoni një plan të koordinuar të ngjyrave. Ne kemi marrë ndihmë nga ekspertët e dizajnit për t'i zgjedhur ngjyrat. Ju mund ta pyesni mësimitshëm të artit ose një dizajner nga komuniteti gjë që do t'ju ndihmonte shumë. Përzgjedhja e ngjyrave të duhura do t'u ndihmonte nxënësve që të çlodhen dhe të përqendrohen.

- Ngjyrosni tavanin dhe pjesën e sipërme të mureve me ngjyra të lehta për ta bërë dhomën të duket më e ndritshme dhe më e madhe.
- Gjysma e poshtme e murit mund ta ketë një ngjyrë më të errët në mënyrë që të mos dallohen shenjat e bëra nga gishtat dhe këmbët.
- Orenditë dhe tabelat për ekspozim mund të kenë ngjyra më të ndritshme për të sjellë ngrohtësi dhe interesim në klasë.

PËRGATITJA E MUREVE

Kemi parë se është e rëndësishme të përgatiten muret mirë para ngjyrosjes. Disa mure ishin të dëmtuara rëndë dhe ri-suvatimi ishte i nevojshëm para se të mund të fillonte ngjyrosja. Vendosëm "shirita" të drurit rreth e përçark dhomës në të njëjtën lartësi si tavolinat në mënyrë që suva të mos dëmtohej.



NDRIÇIMI

Në shumë klasa, patëm nevojë për t'i zëvendësuar dritat. Ndriçimi i mjaftueshëm është i rëndësishëm në mënyrë që nxënësit të punojnë dhe të lexojnë në mënyrë të rehatshme. Duke instaluar llamba me energji të ulët ne gjithashtu zvogëluam faturat e energjisë elektrike të shkollës, dhe poashtu i blemë llambat me zbritje. Punët elektrike gjithmonë duhet të kryhen nga një elektrikist i kualifikuar, por ne zakonisht i patëm ata në dispozicion në mesin e anëtarëve të familjeve dhe punonjësve të komunës.

PUNËT TJERA ELEKTRIKE

Kemi kërkuar nga një elektrikist i kualifikuar që t'i kontrollojë qarqet elektrike për t'u siguruar se janë të sigurta për kompjuter dhe pajisje tjera elektrike. Në disa klasa, patëm nevojë që të ofronim kablllo shtesë për kompjuterë. Në rastet kur do të përdorej një projektor kemi vendosur mbajtëse në tavan ku do të mund të vendosej ai. Kjo është më e përshtatshme dhe gjithashtu e zvogëlon rrezikun e dëmtimit të projektorit.



KËSHILLA KRYESORE

Ngjyrosni një mur ose një pjesë të murit me të bardhë për të krijuar një ekran të projektorit. Nëse do të keni prezantime të rregullta kompjuterike, merrni parasysh vendosjen në mur të një televizori me ekran të sheshtë, në vend të shfrytëzimit të një projektorit.



DRITARET

Që të dyja, edhe perdet por edhe roletat ofrojnë hije nga dielli, por perdet gjithashtu zbusin tingujt në klasë dhe janë më të lehta për t'i hequr dhe larë.

Kur nuk arritëm të gjejmë donatorë për të na ofruar perde ose roleta, prindërit i bënë perdet për klasë.



DYSHEMEJA

Gjatë shumicës së renovimeve tona, shkollat parapëlqenin t'i mbulonin dyshemetë e vjetra me tepihë ose linoleum.

- Tepihu është më i rehatshëm për t'u ulur në të dhe bën që klasa të jetë më e qetë pasi që e zvogëlon jehonën dhe zhurmën e hapave.
- Linoleumi është më i miri për qendrat e artit ose të shkencës pasi që është më i lehtë për t'u pastruar në qoftë se mbi të derdhet uji i ngjyrës.

Nëse keni një dysheme druri, mendoni rreth ri-lëmimit dhe lus-trimit të saj, në vend se ta mbuloni atë. Nëse mund ta huazoni një lëmues dyshemeje nga një kompani lokale, kjo do të ishte një op-sion i mirë. Për ta mbajtur dyshemenë të pastër, është ide e mirë që të kërkonit nga fëmijët t'i ndërrojnë mbathjet e tyre dhe të marrin pantofla para se të hyjnë në klasë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse në klasë ka tepih.



KONTROLLI I CILËSISË

Është ide e mirë nëse emërohet dikush që të jetë përgjegjës për kontrollin e cilësisë gjatë renovimeve. Ky mund të jetë drejtori i shkollës ose një person teknik. Ata do të përkujdesen që skajet të jenë të drejta, që gjërat të jenë të varura horizontalisht dhe vertikalisht, që sipërfaqet të jenë të lëmuara dhe se nuk ka tehe të mprehta që do të mund t'i lëndonin nxënësit. Mund të jenë edhe përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë gjatë punimeve.

KËSHILLA KRYESORE

Për t'i mbajtur perdet e pastra dhe për ta parandaluar pluhurin në klasë, pyesni prindërit që ta organizojnë punën me radhë për t'i larë perdet në fund të çdo gjysmëvjetori.

Vendosni "shirita" druri nëpër klasë në të njëjtën lartësi si tavolinat në mënyrë që suva të mos dëmtohet nga orenditë.

KRIJIMI I MATERIALEVE PËR MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE

Pasi të jenë vendosur raftet në klasë ku do të mbahen gjësendet, mund të filloni t'i krijoni mjetet ndihmëse për mësimdhënie dhe mësimnxënie.



Të nxënit me materiale konkrete krijojnë një të kuptuar më të fortë se sa leximi nga tekstet shkollore dhe u mundëson nxënësve që t'i zhvillojnë shkathtësitë praktike të cilat do t'u nevojiten në jetën reale. Përdorimi i materialeve mësimore krijojnë mundësi për një nxënie aktive, e cila ua bënë të mundur fëmijëve kultivimin e aftësive të të menduarit kritik, duke bërë pyetje, zgjidhur probleme dhe duke marrë kontrollin mbi të nxënit e tyre. Materialet e krijuara nga mësimdhënësi dhe nxënësit janë shpesh më efektive se sa produktet komerciale, sepse ato janë krijuar për një qëllim të caktuar. **Nga krijimi i materialeve mësimore përfitojnë mësimdhënësit por gjithashtu edhe nxënësit.** Gjatë krijimit të materialeve mësimore, mësimdhënësit fitojnë një ide më të qartë rreth koncepteve që ata duan t'ua mësojnë fëmijëve. Kjo gjithashtu zhvillon intuitën dhe krijimtarinë e mësimdhënësit. Kur nxënësit përdorin materiale për të nxënë në mënyrë të pavarur në klasë, kjo i ofron mësimdhënësit kohë për t'u dhënë ndihmë shtesë individëve dhe grupeve të vogla.

Ku do t'i marr materialet?



Kërkoni nga nxënësit tuaj që të mbledhin materiale të ricikluara

Shumë materiale që mësimdhënësit gjejnë dhe sjellin në klasë janë tashmë në dispozicion për t'u përdorur. Kështu pra, klasa mund të pajiset pa asnjë shpenzim. Duke kërkuar nga nxënësit që të mbledhin materiale të ricikluara, mësimdhënësi mund natyrshëm t'i përfshijë prindërit dhe komunitetin në jetën e përditshme të klasës.



Kutitë dhe shishet e plastikës ... paraqesin kontejnerë të shkëlqyeshëm.

Kutitë e akulloreve dhe të djathit janë ideale për mbajtjen e gjërave të vogla. Preni pjesën e lartë të një shisheje të plastikës për të krijuar një kontejnerë për ruajtjen e gjësendeve më të gjata (p.sh. lapsave)



Kutitë nga kartoni

... mund të shfrytëzohen për ruajtje e gjësendeve të vogla dhe të përdoren si materiale në matematikë, art dhe teknologji.

KËSHILLA KRYESORE

Rrotulloni kartonët nga brenda jashtë dhe ri-ngjitni ata. Fëmijët do të kënaqen gjatë dekorimit dhe etiketimit të tyre.

Unë nuk kam kohë t'i bëjë të gjitha gjërat që më nevojiten!



Kolegët, prindërit dhe nxënësit mund t'ju ndihmojnë.

Nxënësit më të rritur do të kënaqen duke bërë gjëra për nxënësit më të vegjël. Madje mund të bëjnë edhe libra që fëmijët t'i lexojnë. Të punuarit së bashku me kolegët për të krijuar materiale të mësimdhënies dhe të të nxënit mund të jetë një aktivitet gazmor dhe krijues.

KËSHILLA KRYESORE

Nëse ekziston një Qendër për Ngritje Profesionale në komunën tuaj, mësimdhënësit mund të organizojnë seanca për të krijuar materiale duke shfrytëzuar pajisje, siç është një laminator (makinë plastifikuese). Gjithashtu mund të shkarkoni dhe të printoni burime nga interneti duke shfrytëzuar kompjuterë dhe printerë që janë në dispozicion.



... por unë e ndaj klasën time me nxënës të ndërrimit tjetër. Si do t'i mbaj të sigurt gjërat e mia?



Planifikoni renovimin e klasës me kolegun tuaj me të cilin e ndani klasën.

Përfshini përfaqësues të prindërve nga të dy klasat.

Ekzistojnë shembuj të tillë shumë të mirë të renovimit të klasave të filmuar nga RTK. Për shembull:

- Një klasë në Prishtinë shfrytëzohet nga një mësues i klasës së 1-rë dhe një mësues i klasës së 5-të.
 - Klasa në Kllokot në mëngjes shfrytëzohet nga një klasë që mëson në gjuhën serbe dhe pasdite nga një klasë shqipfolëse.
- Krijoni kontejnerë për t'i mbajtur gjërat që bëni ju dhe etiketoni ato në mënyrë që fëmijët të mësojnë t'i lexojnë etiketat dhe t'i gjejnë gjërat për vete.

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Basic Education Program i USAID-it organizon kurse për mësimdhënësit e shkollave fillore të mesme të ulëta me ide për të krijuar materiale arsimore. Për më shumë informata rreth kurseve të organizuara nga Basic Education Program, shih Shtojcën A.

Donatorë të tjerë, të tillë si GIZ dhe KulturKontakt, gjithashtu ofrojnë kurse të ngjashme.

KËSHILLA KRYESORE

Ngritni fonde nga riciklimi ...

Shishet e plastikës, kanaçet e aluminit dhe letrat, të gjitha këto riciklohen në Kosovë. Mund t'i bleni edhe "pajisjet për shtypjen e shisheve plastike" në mënyrë që ato të ruhen më lehtë. Nëse dëshironi të bëheni një "Shkollë e gjelbër" dhe të merrni pjesë në riciklim, kontaktoni Basic Education Program.

RREGULLIMI I KLASAVE 1 DERI 5

Katër nga klasat e përfshira në programet televizive për Renovimin e Klasave shfrytëzohen nga klasat 1 deri 5:



Në shtator të vitit 2011, ne filmuam në shkollën fillore të mesme të ulët "17 Shkurti", një shkollë e vogël rurale, në Banjë të Malishevës. Më shumë se 30 prindër, mësime dhe anëtarë tjerë të komunitetit punuan së bashku për t'i çmontuar tavolinat dhe ornditë e vjetra të dëmtuara, dhe për t'i renovuar dhe ngjyrosur muret e klasës. Prindërit dhe komuniteti i formuan ekipet e punës në oborrin e shkollës për t'i ringjyrosur pjesët e sipërme të tavolinave të vjetra për të krijuar prej tyre rafte dhe dollape të reja. Shumë biznese private dhuruan perde, ngjyra, llamba të reja elektrike dhe pajisje ndihmëse për mësim.

Në tetor, ne filmuam në shkollën fillore të mesme të ulët "Zef Lush Marku", në fshatin Brekoc të Gjakovës. Ky program u përqendrua në krijimin e një biblioteke dhe një këndi të leximit në klasë. Prindërit dhe mësime dhe anëtarë tjerë të komunitetit punuan për ta transformuar një klasë të zhveshur në një mjedis pune tërheqës dhe miqësor për fëmijët me ndihmën e ekipit të programit.



Në tetor kemi filmuar një renovim tjetër në Mogillë, një fshat i vogël në komunën e Kllokotit. Shkolla fillore e mesme e ulët "Gjon Sereqi" ka dy ndërtesa shkollore në lokacione të ndryshme brenda fshatit.. Ndërtesa e vjetër, ku mësojnë nxënësit më të vegjël, ishte në gjendje më të keqe dhe ky ishte vendi ku u zhvillua renovimi i klasës. Në mëngjes ajo u shërben nxënësve që mësojnë në gjuhën serbe dhe pasdite nxënësve në gjuhën shqipe. Programi televiziv shfaq renovimin e një klase për nxënësit e klasës së parë. Mësuesit dhe prindërit punuan së bashku me ekipin e renovimit të klasës për të krijuar një mjedis më të mirë të mësimi. Xhirimet u përqendruan në këndin e matematikës në klasë dhe rreth krijimit të mjeteve ndihmëse të mësimit dhe të mësimit.

Programi i fundit u filmua në shkollën fillore të mesme të ulët "Gjergj Fishta", një shkollë e madhe urbane në Prishtinë. Fokusi kryesor arsimor në këtë episod ishte në teknologjinë e informimit dhe në shkencë. Ambasadori amerikan vizitoi këtë klasë për ta parë renovimin e saj.



Për klasat 1 deri 5 ne synuam të krijojmë një klasë që ka fëmijët në qendër, e cila mbështetë zgjedhjen, hulumtimin, përgjegjësinë personale, bashkëpunimin, komunikimin dhe respektin. Ne e ndamë klasën në qendra për aktivitete të të nxënësve e cila përfshinte:

- qendrën e leximit dhe shkrimit;
- qendrën e matematikës, me mjetet ndihmëse për t'u ndihmuar nxënësve që t'i kuptojnë konceptet matematikore;
- një qendër të shkencës me hapësirë dhe materiale për t'u mundësuar të zhvillojnë aktivitete praktike shkencore;
- qendrën e artit me materiale për pikturim, vizatim dhe modelim;
- një qendër të kompjuterëve ku nxënësit mund ta përdorin teknologjinë bashkëkohore; dhe
- qendrën e dramës/lojës kreative, duke përfshirë edhe një teatër kukullash.



Këto qendra të aktiviteteve janë bazë për organizimin e klasës e cila mundëson të nxënësve aktiv. Ato janë shumë më efektive sa i përket shpenzimeve se sa metodat e vjetra mësimore sepse ata kanë nevojë për një numër më të vogël të pajisjeve, në krahasim me metodat e vjetra ku të gjithë nxënësit bëjnë të njëjtën gjë në të njëjtën kohë. Nxënësit, bëjnë ndërrime, me një radhë të organizuar, për t'i shfrytëzuar këto materiale dhe për të fituar përvojë praktike.



Qendrat tona të të nxënësve të aktivitetit përmbajnë një shumëllojshmëri të materialeve të cilat fëmijët i përdorin në mënyrë kreative. Materialet janë zgjedhur me kujdes nga ekspertët dhe mësime dhe anëtarë tjerë të komunitetit për ta inkurajuar hulumtimin dhe janë të ekspozuara në mënyrë tërheqëse në rafte për përdorim të lehtë. Fëmijët duhet të inkurajohen që të punojnë me materiale në mënyrë të pavarur. Qendrat e të nxënësve dhe puna në grupe të vogla u mundëson fëmijëve ndërveprime natyrore dhe mundësinë për të mësuar nga njëri-tjetri. Kjo u jep atyre mundësinë për t'i zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të ushtruar si të shprehën, për të mësuar rreth dallimeve, për t'u bërë më të pavarur dhe për të mësuar nga moshatarët e tyre.

Nuk janë rregulluar të gjitha klasat në të njëjtën mënyrë por të gjitha qendrat janë rregulluar në një mënyrë logjike që i përshtaten moshës së nxënësve dhe plan-programeve (për shembull, qendrat e zhurmshme pranë njëra-tjetrës). Qendrat duhet t'i përfshijnë të gjitha materialet e nevojshme për plan-programet.

KËSHILLA KRYESORE

Për ta mbajtur klasën tuaj të pastër dhe për ta zvogëluar zhurmën kur nxënësit lëvizin nëpër të kërkoni prej tyre që të sjellin pantofla në shkollë dhe t'i ndërrojnë këpucët para se të hyjnë në klasë.



Qendra e leximit dhe shkrimit është vendi ku nxënësit ushtrojnë lexim, shkrim dhe aftësitë tjera të komunikimit. Një vlerësim i letërsisë duhet të trajtohet në klasë çdo ditë. Qendra mund të përfshijë një bibliotekë të qetë dhe zonën e leximit me libra dhe materiale tjera të leximit. Kjo hapësirë e qetë u mundëson fëmijëve që të shfletojnë libra, të lexojnë për njëri-tjetrin dhe u mundëson të rriturve që të lexojnë për fëmijët.

Ne mbuluam dyshemenë me tepihë dhe jastëkë të butë. Kjo e ndihmon zvogëlimin e zhurmës dhe është më e rehatshme për lexim.

Ambienti fizik i leximit dhe shkrimit duhet të planifikohet me kujdes. Fëmijët mësojnë duke vepruar, prandaj ambienti në klasë duhet të pasqyrojë situata të jetës reale. Fëmijët mësojnë nga moshatarët e tyre sikurse që mësojnë nga të rriturit, ata janë në gjendje të mësojnë nga përvojat e veta dhe t'i ndërli-dhin ato me përvojat e të tjerëve. Kjo ndihmon në ndërtimin e diskutimeve të pasura dhe e bënë ndërveprimin në mes të nxënësve gjatë procesit të të nxënimit tepër të rëndësishëm.



Çfarë materialesh mund të jenë në dispozicion në qendrën e leximit dhe shkrimit?

Varësisht nga klasa/mosha, mendoni rreth këtyre:

- libra të përshtatshëm për grupmoshën,
- libra të krijuar nga fëmijët,
- enciklopeditë,
- fjalorët,
- alfabetet,
- një mur fjalësh,
- fjalor muri,
- litar për tharje rrobash,
- karta shkronjash ose fjalësh varësisht nga klasa/mosha,
- revista,
- postera me poezi, tregime dhe këngë,
- mbishkrime me citate,
- letër, lapsa, stilolapsa, shkumësa me ngjyrë/ngjyra,
- goma për fshirje, ngjitës,
- materiale për krijimin e librave,
- kompjuterë,
- video kamera,
- kukulla,
- marioneta dhe kukulla në formë kafshësh,
- maska dhe kostume për dramë.



Këndi i leximit dhe shkrimit gjithashtu duhet t'i zhvillojë aftësitë e komunikimit verbal.

Për klasët e ulëta, pranë qendrës së leximit dhe shkrimit mund të vendoset qendra e aktivitetit të dramës. Fëmijët duhet të inkurajohen që t'i kombinojnë librat me shfaqjet e dramës. Prandaj është e nevojshme të ketë pajisje për dramë siç janë kukullat, marionetat, kukullat në formë kafshësh dhe kostumet e ndryshme.

Nxënësit më të rritur mund t'i bëjnë dhe redaktojnë vet filmat e tyre.

Vetëvlerësimi dhe Vlerësimi i Ndërsjellë

Përkujdesuni që të ketë materiale në dispozicion në këndin e leximit dhe shkrimit në mënyrë që nxënësit ta vlerësojnë dhe ta korrigjojnë vet punën e tyre.

Materialet mund të përfshijnë:

- lista fjalësh dhe fjalorë në mënyrë që ata të kenë mundësi ta kontrollojnë germëzimin,
- një fjalor sinonimesh apo mur fjalësh që ata të mund ta identifikojnë fjalorin alternativ,
- postera me këshilla gramatikore dhe për shenjat e pikësimit që ata të kenë mundësi ta korrigjojnë çdo gabim të bërë,
- lista të kriterëve të vlerësimit për detyra në mënyrë që ata të dinë se çfarë është e rëndësishme.



Krijimi i librave

Krijimi i librave është shumë më interesant se shkrimi i një kopje libri. Përmes "Krijimit të Librave" fëmijët e paramendojnë veten si "autorë". Ata mund të krijojnë libra, gazeta, revista, letra dhe materiale tjera të shkruara. Në kompjuter ata mund të shkruajnë e-maile dhe blogje. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë se si përdoret gjuha e shkruar në situata të botës reale dhe i motivon ata për të shkruar më mirë. Ofroni materiale për krijim të librave në qendrën e leximit dhe shkrimit, si letra në madhësi të ndryshme, modele dhe ngjyra, lapsa me ngjyra, shënues, karta, kapëse, hapës të vrimave, ngjitës, gjilpëra dhe pe, dhe gjësende tjera të dobishme për të bërë libra vet. Temat e librave mund të jenë në lidhje me kurrikulën aktuale por gjithashtu edhe me jetën e përditshme të fëmijëve apo fantazitë e tyre. Fëmijët mund ta bëjnë librin e vet individual, por ata gjithashtu mund të krijojnë libra në çifte ose në grupe. Pasi që e kanë shkruar librin e tyre, mund ta prezantojnë atë nga "karrigia e autorit" (shih faqen tjetër), para se ai t'i bashkëngjitet koleksionit të bibliotekës. Aktiviteti i krijimit të librave jo vetëm që i ndihmon fëmijët t'i fitojnë aftësitë e shkrim-leximit, por gjithashtu e rrit vetëbesimin dhe pavarësinë e tyre.

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Ne jemi duke organizuar kurse për Vlerësimin për të Nxënimit për të gjithë mësimdhënësit e shkollave fillore të mesme të ulëta ..shih shtojcën A në fund të këtij libri.

KËSHILLA KRYESORE

Nxënësit më të rritur do të kënaqen duke krijuar gjësende për nxënësit më të rinj. Mund t'i krijojnë edhe librat e vet që t'i lexojnë fëmijët më të vegjël. Mund të bëjnë postera me poezi dhe këngë të ilustruara. Gjithashtu mund të lexojnë tregime për fëmijët më të vegjël dhe t'i dëgjojnë shokët e tyre më të rinj duke lexuar.



Karrigia e autorit

Nxënësit që shkruajnë vet tregime, poezi dhe libra, mund t'i lexojnë ato nga "karrigia e autorit", para se ato t'i bashkëngjiten koleksionit të bibliotekës.

Mundohuni ta gjeni një karrige me formë të pazakontë apo ndryshe nga të tjerat. Ne e dekoruam karrigen që shihet në fotografi për ta bërë atë edhe më të rëndësishme për nxënësit.

Kur fëmijët ulen në këtë karrige të veçantë për t'i lexuar punimet e tyre më të mira para fëmijëve të tjerë, ata ndjehen të rëndësishëm dhe ky aktivitet i inkurajon ata që të shkruajnë më me kujdes dhe me më shumë vëmendje.

Mësimdhënësi apo ndonjë vizitor mund ta përdorin karrigen kur u lexojnë nxënësve.

Muret e fjalëve

Nxënësit i shkruajnë fjalët në kartela dhe këto ekspozohen në mur në mënyrë që të gjithë fëmijët të kenë mundësi t'i shohin (sidomos nga qendra e shkrimit në klasë). Në klasat e ulëta mësimdhënësit mund t'i shkruajnë fjalët (p.sh. 20 fjalët më të zakonshme në gjuhën shqipe), por fëmijët shumë shpejt do të dëshirojnë që vet t'i kopjojnë ato.

Në klasat më të ulëta, muret e fjalëve mund t'i paraqesin fjalët të cilat nxënësit i hasin gjatë leximit të tyre dhe fjalët tjera që përdoren shpesh. Fjalët e reja mund të shtohen në murin e fjalëve çdo javë. Pasi që madhësia e "murit të fjalëve" rritet, nxënësit mund të ndjehen krenar kur e shohin se sa fjalë kanë mësuar. Ekspozimi i fjalëve në mur i ndihmon fëmijët të bëhen më të interesuar rreth tyre dhe të kuptojnë se fjalët janë të rëndësishme dhe mund të përdoren pa pushim. Muri i fjalëve u ndihmon atyre t'i mësojnë shkronjat, sipas rendit alfabetik dhe raportin ndërmjet tingullit dhe shkronjës. Ai ofron ekspozim shtesë dhe sfidë për nxënësit që janë në nivele të ndryshme të shkathtësive dhe interesimit. Nxënësit mund të referohen në faqet e tyre personale të murit të fjalëve gjatë projekteve të shkrimit apo shkrimit të ditarëve. Muret e fjalëve janë sugjerime të vazhdueshme të të nxënit për nxënësit, ata mund ta përdorin murin e fjalëve si një fjalor të madh dhe t'i kërkojnë në mur fjalët kur janë të pasigurt se si ta gërmëzojnë një fjalë.

Mësuesit e klasave të 4-ta dhe 5-ta mund ta përdorin murin e fjalëve për t'i ekspozuar fjalët më të sofistikuara që mund të zëvendësohen me fjalët që përdoren më shpesh, duke zhvilluar kështu një fjalor më të gjerë tek nxënësit e tyre.



Fjalori i murit

Fjalori i murit është i ngjashëm me murin e fjalëve, por ky ka xhepa për t'i mbajtur kartelat me fjalë. Ai është i dobishëm në shkollat që punojnë me ndërrime, ku klasat e ndryshme mund të kenë nevojë për të mësuar fjalë të ndryshme. Fjalori i murit varet në mur dhe mund të hiqet lehtë dhe të zëvendësohet me një tjetër. Nxënësit mund ta përdorin fjalorin e murit si një fjalor të vërtetë. Ata mendojnë për shkronjën e parë të fjalës dhe e kërkojnë në xhepin përkatës për ta gjetur fjalën e cila u nevojitet.

Për ta bërë fjalorin e murit duhet të qepni xhepa të mjaftueshëm në të dhe ta shënoni çdo xhep me një shkronjë të alfabetit. Mund të bëni fjalorë muri për të gjitha gjuhët, vetëm përkujdesuni që të bëni numër të saktë xhepash. Sigurohuni që të lëni hapësirë në krye dhe në fund të fjalorit të murit për pjesë të rrumbullakëta druri ose kallami. Këto e mbajnë formën e fjalorit të murit dhe në pjesën e epërme të drurit është i lidhur një tel për varje.


Mësimdhënësi ose fëmijët mund t'i përgatisin etiketat e letrës për t'i ngjitur në xhepa. Mësimdhënësi mund t'i vendosë disa kartela me fjalët themelore në fjalorin e murit, por fëmijët duhet t'i bëjnë kartelat për çdo fjalë të re që e mësojnë dhe t'i vënë ato në xhepat përkatës.

Nxënësit mund ta përdorin këtë fjalor të murit në çdo kohë për t'ju ndihmuar që ta mësojnë gërmëzimin dhe t'i njohin fjalët e reja. Ai gjithashtu është i mirë për ushtrimin e renditjes alfabetike dhe për t'i mësuar nxënësit se si ta përdorin një fjalor të vërtetë.

Litari i tharjes së rrobave

Litari i tharjes së rrobave mund të shfrytëzohet për matematikë por edhe për aktivitete të leximit dhe shkrimit.

- Shkronjat mund të varen në litarin e tharjes së rrobave në mënyrë që fëmijët të krijojnë fjalë.
- Kartelat me fjalë mund të varen në litarin e tharjes së rrobave për të formuar fjali.
- Nxënësit pastaj mund t'i kopjojnë fjalët dhe fjalitë e tyre në letër ose në fletoret e tyre.



DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Basic Education Program i USAID-it është duke organizuar kurse për lëndën e matematikës për mësimdhënësit e shkollave fillore të mesme të ulëta. Për më shumë informata rreth kurseve të organizuara nga Basic Education Program, shih shtojcën A në fund të këtij libri.

Pse nuk mjafton libri shkollor për mësimin e matematikës?



Libri shkollor është vetëm një nga mjetet për t'i ndihmuar nxënësit ta mësojnë matematikën. Fëmijët kanë nevojë për shumë më tepër. Qendra e matematikës ofron pajisje që do t'u ndihmojnë nxënësve të numërojnë, kategorizojnë dhe të kryejnë operacione të ndryshme matematikore. Me një shumëllojshmëri të materialeve dhe aktiviteteve, nxënësit do të inkurajohen për të zhvilluar mënyra logjike të menduarit dhe argumentuarit që mund të çojnë më tej arsimimin e tyre matematikor dhe ndërtimin e vetëbesimit. Nxënësit mësojnë duke hulumtuar, supozuar, vëzhguar dhe testuar. Në këtë mënyrë ata i zhvillojnë shkathtësitë themelore të matematikës siç janë: zgjidhja e problemeve, mbledhja e të dhënave, vlerësimi i të dhënave, matja dhe gjeometria. Sa më shumë që matematika është e lidhur me jetën e përditshme, aq më shumë nxënësit do ta kuptojnë domosdoshmërinë e matematikës në botën e tyre.

Çfarë duhet të përfshij në Qendrën e Matematikës?



Kjo varet nga mosha e nxënësve tuaj, por pikat në vijim janë të domosdoshme për të gjitha klasat nga e 1-ra deri tek e 5-ta:

- kubet, format dhe figurat gjeometrike,
- peshoret (peshat e bëra nga kontejnerët e mbushur me rërë),
- vizoret dhe pajisjet matëse,
- lojrat matematikore,
- kartelat me numra dhe një "litar i tharjes së rrobave",
- objekte për numërim, kategorizim dhe klasifikim p.sh. kapak shishesh, shkopinj etj.
- postere me numra, simbole matematikore,
- fleta dhe grafik me katrorë (letra milimetrike).

Bëni klasën tuaj një vend ku fëmijët mund të bëhen matematikanë

Të kuptuarit e vërtetë të matematikës do t'u ndihmojë individëve që të përparojnë në vendin e punës dhe në jetën e tyre personale. Për fat të keq mësimdhënia tradicionale e matematikës është gjithnjë e më e parëndësishme për botën bashkëkohore sepse ajo përqendrohet në llogaritjet sipas mënyrave të vjetra, e cila tashmë në biznes, industri dhe hulumtime shkencore kryhet nga kalkulatorët dhe kompjuterët.

Aritmetika mendore tani është shumë më e rëndësishme se sa llogaritja me shkrim dhe fëmijët duhet ta zhvillojnë shkathtësinë për të vlerësuar dhe llogaritur në mend. Ata gjithashtu duhet të dinë se si punojnë kalkulatorët elektronik (shih faqen 33).



Bëni një rresht numrash në dysheme

Shënoni një rresht diskret numrash në dysheme (shih majtas). Është e rëndësishme që të përfshihet zeroja në rresht. Madhësia e secilit katror duhet t'ua mundësojë nxënësve të shkelin lehtë nga njëri katror në tjetrin. 50 cm janë dimensionet e dhura për secilin katror.

Ky rresht mund të jetë i thjeshtë, sikur në rastin e prezantuar apo mund të bëhet më tërheqës për t'i ngjasuar një gjarpëri apo shiriti me shumë ngjyra. Ai mund të jetë i përkohshëm/lëvizshëm për përdorim në orë të veçanta mësimi ose i shënuar në dysheme, që fëmijët të kenë mundësi të luajnë dhe ushtrojnë me të. Rreshtat e tillë mund ta bëjnë edhe oborrin e shkollës një mjedis më tërheqës.

Në rastet ku hapësira e klasës është e kufizuar, numrat mund të pikturohen në copëza të ndryshme si tepih apo plastikë. Format mund të bëhen më tërheqëse si lule apo gjethe.

1. Aktivitetet e numërimit

Për t'i ndihmuar fëmijët që ta kuptojnë korrespondencën një-me-një, ata hedhin hapin dhe numërojnë në të njëjtën kohë. Një fëmijë mund të hedh hapin. I gjithë grupi mund të numërojë. Ata mund të numërojnë përpara dhe prapa.

2. Aktivitetet e mbledhjes.

- Filloni nga 0, dhe më vonë filloni nga vende të ndryshme;
- Për të shtuar 3, bëni 3 hapa. Ku gjendeni tani?;
- Kërkoni nga fëmijët të parashikojnë se ku do të jenë para se të fillojnë?;
- Kërkoni nga fëmijët të mbyllin sytë dhe të përpiqen të parashikojnë;
- Në vend se t'i tregoni fëmijëve se çfarë të bëjnë, mbani një kartelë me udhëzime p.sh. [+3];
- Çiftet dhe grupet e fëmijëve mund t'i ushtrojnë aktivitetet duke përdorur kartela të tilla.

3. Aktivitetet e zbritjes

Përsëriteni sikurse me 3-shin por lëvizni me hapa prapa.

4. Procedurat komplekse

- Tregoni dy ose më shumë udhëzime (p.sh. [+3] [-2])
- Kërkoni nga fëmijët të parashikojnë se ku do të përfundojnë. Me nxënësit e rritur përfshini numrat negativ.





Aktivitetet me një qind katrorë

Kërkoni nga fëmijët që t'i ngjyrosin shumëfishet e numrave të ndryshëm në mënyrë që t'i gjejnë vargjet. Diskutimi rreth këtyre mund t'u ndihmojë nxënësve t'i mësojnë faktet rreth shumëzimit.

Lejoni fëmijët që të luajnë lojëra të tilla si 'Gjarpërinj dhe Shkallë' në mënyrë që të familjarizohen me numrat.

Kërkoni nga nxënësit që t'i hulumtojnë vargjet diagonale. (Për shembull, katrorët e verdhë)

Si rriten numrat në kolonën vertikale? Si rriten ata në rreshtin horizontal?

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2	4	6	8	10	12	14	16	18	20
3	6	9	12	15	18	21	24	27	30
4	8	12	16	20	24	28	32	36	40
5	10	15	20	25	30	35	40	45	50
6	12	18	24	30	36	42	48	54	60
7	14	21	28	35	42	49	56	63	70
8	16	24	32	40	48	56	64	72	80
9	18	27	36	45	54	63	72	81	90
10	20	30	40	50	60	70	80	90	100

Katrori i shumëfishtë

Nxënësit duhet t'i dinë faktet e numrave siç është tabela e shumëzimit, por ekzistojnë mënyra shumë më interesante dhe efektive të mësimin të tyre se sa thjesht të mësuarit përmendësh.

Kërkoni nga fëmijët që t'i ngjyrosin njësitë brenda çdo kolone në mënyrë që ta gjejnë lidhshmërinë.

p.sh. njësitë në shumëfishet e numrit nëntë:

9 18 27 36 45 54 63 72 81 90

janë ...

9 8 7 6 5 4 3 2 1 0

Ktheni mbrapsht rezultatet dhe kërkoni për lidhshmëri të ngjashme.

Për shembull shumëfishet e numrit katër ...

04 08 12 16 20 24 28 32 36

Janë të njëjtë sikurse shumëfishet e numrit 6 të kthyer mbrapsht.

54 48 42 36 30 24 18 12 06

Kërkoni nga nxënësit që t'i hulumtojnë lidhshmëritë diagonale. (Për shembull, katrorët e verdhë)

Diskutimi për këto lidhshmëri mund të ndihmojë në ngjalljen e interesimit të nxënësve rreth numrave dhe t'i ndihmojë ata që t'i mësojnë faktet e shumëzimit.



Krijoni "litarin e tharjes së rrobave" në klasë

Krijoni kartelat me numra dhe varni ato me kapëse në "litarin e tharjes së rrobave" për të krijuar një rresht numrash. Proveni këto aktivitete ...

1. Përzieni kartelat dhe kërkoni nga nxënësit t'i rradsisin ato.
2. Kërkoni nga nxënësit që t'i vënë vetëm numrat tek (ose edhe numrat çift, ose shumëfishet e numrit 3 etj.) në litarin e tharjes së rrobave.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70
71	72	73	74	75	76	77	78	79	80
81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100

Krijoni një katror të qindshes

Katrori i qindshes është thjesht një vazhdim i rreshtit të numrave. Kjo u mundëson nxënësve që në koncept të përfshijnë numra më të mëdhenj.

Për shkak se rreshtat janë në dhjetëshe, ata e theksojnë sistemin e numrave me dhjetëshe bazë.



PËRDORIMI I TIK-ut (Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit) NË KLASË

Renovimi i fundit i klasës u përqendrua në TIK: Puna e asaj jave filloi rreth përgatitjeve për Renovimin e Klasave në shkollën fillore të mesme të ulët "Gjergj Fishta", në Prishtinë. Xhirimet u zhvilluan nga RTK-ja më 21 dhe 22 tetor dhe përfunduan më 24 tetor. Fokusi i këtij programi është mbi shfrytëzimin e TIK-ut dhe të teknologjisë moderne në klasë. Aktivitetet përfshijnë: aktivitetet matematikore, siç është gjenerimi i modeleve dhe sekuencave me kalkulatorë; vizatimi i formave dhe modeleve me kompjuter; aktivitetet shkencore si përdorimi i një mikroskopi elektronik për t'i vëzhguar detajet dhe sondat për të matur temperaturën në eksperimente. Nxënësit nga Klubi Teknik për Përkrahjen e Nxënësve të Shkollës formuan ekipin e vet të filmit dhe përdorën 'Flip' kamera për t'i regjistruar aktivitetet dhe për ta krijuar vet një video-film.

Shfrytëzimi i kompjuterit për ta mësuar dhe hulumtuar matematikën

Shfrytëzimi i kompjuterëve dhe kalkulatorëve nga nxënësit më të rritur në orët e matematikës është një zgjedhje e qartë. Këto janë mjetet themelore të të gjithë matematikanëve, shkencëtarëve dhe bizneseve. Kanë ikur në pa kthim ditët kur ne kishim nevojë për llogaritje në letër. Por edhe nxënësit e rinj do të mësojnë që ta kuptojnë dhe ta ushtrojnë më mirë matematikën në qoftë se kanë në dispozicion në klasët e tyre kalkulatorë dhe kompjuterë.

Në qoftë se nxënësit tuaj kanë qasje në kompjuterë ekzistojnë shumë burime në dispozicion në internet për t'u ndihmuar nxënësve që ta mësojnë dhe ta hulumtojnë matematikën. Programet në formë tabelore përdoren për qëllime të kontabilitetit dhe shumica e nxënësve duhet të familjarizohen me përdorimin e tyre në mënyrë që ata t'i kenë shkathtësitë e nevojshme për biznesin bashkëkohor. Një aplikacion tjetër i fuqishëm kompjuterik për arsimim është një gjuhë programimi e quajtur LOGO.

Qëllimi i LOGO-s është që t'i mësojë njerëzit (fëmijët dhe të rriturit) se si të kryhet programimi. Ai është modeluar sipas një gjuhe të popullarizuar dhe të fuqishme të quajtur LISP dhe është aq e fuqishme si çdo gjuhë tjetër e programimit. "Turtle graphics" mbush një boshllëk që shumica e gjuhëve tradicionale nuk e bëjnë. Domethënë, ajo i jep informatat kthyesë të menjëhershme, çka e bënë atë më gazmore dhe më të lehtë për ta mësuar programimin.

LOGO ka një tipar unik të quajtur "Turtle Graphics". Turtle Graphics është një grup i thjeshtë dhe i fuqishëm i komandave që përdoren për ta manipuluar një objekt të ekranit të quajtur breshkë. Quhet "breshkë" sepse versioni i parë i LOGO-s përdori një robot elektronik që i ngjante një breshkë. Roboti tërhoqi vija në një copë të madhe të letrës që ishte e shtruar në dysheme. Në një ekran kompjuteri breshka është thjeshtë një kursur që mund të tërheq vija dhe të krijojë forma. Kjo është veçanërisht e dobishme në shkollat fillore për nxënësit që janë të interesuar në Gjeometri dhe në Koordinatat Karteziane.

Një version falas dhe i shkarkueshëm i LOGO-s, i quajtur "FMSLogo" është në dispozicion në faqen e internetit:

<http://fmslogo.sourceforge.net>

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Basic Education Program i USAID-it është duke organizuar kurse për mësimdhënësit e shkollave fillore të mesme të ulëta që e përfshijnë përdorimin e TIK-ut në matematikë. Për më shumë informata rreth kurseve të organizuara nga Basic Education Program, shih shtojcën A në fund të këtij libri.



Përdorimi i kalkulatorëve

Ne nuk mund t'i injorojmë kalkulatorët në shkolla. Ata janë një fakt i përditshëm i jetës. Fëmijët kanë nevojë të dinë se si t'i përdorin, por gjithashtu edhe të jenë të vetëdijshëm për kufizimet e tyre dhe domosdoshmërinë e posedimit të një aftësie të mirë të vlerësimit.

Kalkulatorët mund t'i luajnë disa role të ndryshme. Përpos që kryejnë llogaritjet, ato përfshijnë:

- ndihmën për nxënësit që t'i hetojnë sekuencat dhe modelet (për shembull, duke përdorur funksionin e operatorit konstant);
- kontrollimin e përgjigjeve të arritura me llogaritje në mend ose duke përdorur një metodë të shkruar;
- mbështetjen e ushtrimeve të shkathtësive rutinore në kontekstin e një loje.

Nëse përdoren siç duhet, ata mund të zhvillojnë të nxënësit e pavarur dhe të përgjegjshëm duke e ulur varësinë nga mësimdhënësi.

Përdorni një kalkulatorë për t'i ndihmuar fëmijët që ta mësojnë tabelën e shumëzimit:

1. Tregoni fëmijëve se si kalkulatori mund të llogarisë në 3-she duke shtypur +3 pastaj shtypjen e përsëritur të butonit =. (Përdor të njëjtën metodë për shumëfishet e tjera.)
2. Zhvilloni bashkëpunimin në vend të konkurrencës, për t'i mësuar tabelat duke prezantuar 'Mposhte kalkulatorin' si në vijim ...

Bëni grupe të kartelave për secilën nga tabelat e shumëzimit si kjo më poshtë:

Për të luajtur, vendosni grupin e kartelave të pazbuluara në tavolinë me dy nxënës.

Njëri nga fëmijët ka një kalkulator. Tjetri hap kartelat njëri pas tjetrit dhe duhet të japë përgjigje para se fëmija i parë të tregojë përgjigjen në kalkulator.

Kushdo që fiton e merr kartelën.

Nëse fëmija i dytë fiton më shumë kartela, ai ose ajo e "mposht" kalkulatorin.

Kur një fëmijë i fiton të gjitha kartelat për ta mposhtur kalkulatorin, kjo mund të regjistrohet në një tabelë progresi.



Përdorni një kalkulator për ta lehtësuar vetëvlerësimin dhe vlerësimin e ndërsjellë në matematikë

Fëmijët mund t'i kontrollojnë llogaritjet e veta dhe të njëri-tjetrit duke përdorur një kalkulatorë.

VËREJTJE:

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë nuk duhet të jenë një zëvendësim për kontrollimin e punës së nxënësve nga ana e mësimdhënësit. Mësimdhënësi duhet të bëjë vlerësime të rregullta diagnostike në mënyrë që të gjykojë nëse nxënësve iu nevojitet mbështetje shtesë.

VENDOSJA E KOMPJUTERËVE

Nuk ka asnjë dyshim në lidhje me domosdoshmërinë e kompjuterëve në procesin mësimor. Shumica e shkollave tani kanë laboratore kompjuterike ku nxënësit mësojnë se si t'i përdorin kompjuterët. Sidoqoftë, shumica e nxënësve tashmë e dinë se si ta përdorin kompjuterin, sepse ata i kanë në shtëpi ose shkojnë në një internet kafe. Nxënësit shpesh dinë më shumë për TIK-un se sa mësimdhënësit e tyre.



Nxënësit nuk kanë nevojë të shkojnë në laboratorët kompjuterikë për të mësuar se si t'i përdorin kompjuterët, ata duhet t'i kenë kompjuterët në dispozicion në klasë që t'i përdorin si mjete në të gjitha lëndët e tyre.

- Në orët e gjuhëve kanë nevojë të mësojnë për komunikimin me anë kompjuterëve dhe të kenë qasje falas në literaturë nga interneti;


- Në orët e gjuhëve të huaja, mund të përdorin softuerin falas si "Google Translate", për t'u ndihmuar në të mësuarit e gjuhëve të huaja ose të përdorin Skype-in për të biseduar me nxënës nga vendet tjera;

- Në orët e gjeografisë, mund të përdorin Google Earth për të mësuar më shumë rreth botës dhe vendit të tyre;
- Në matematikë, mund të mësojnë t'i përdorin programet tabelore dhe programimin logjik;

- Në orët e dramës mund t'i përdorin telefonat celularë dhe programet kompjuterike për t'i bërë vet filma;

- Në orët e historisë mund të bëjnë hulumtime dhe t'i prezantojnë gjetjet e tyre.

Lista e përdorimit të TIK-ut në klasë është e pafund dhe ajo shtohet çdo vit.



Ka disa detaje që duhet mbajtur në mend gjatë vendosjes së kompjuterëve në klasë. Nëse jeni duke përdorur kompjuterët e tavolinës atëherë këta duhet vendosur kundrejt mureve dhe pranë prizave elektrike. Nëse shtrirja e prizave elektrike nuk është e përshtatshme, atëherë duhet t'i përdorni kabllot vazhduese për t'i furnizuar kompjuterët e tavolinës me energji elektrike. Këto duhet të jenë të fiksuara përgjatë murit në mënyrë që nxënësit të mos zënë në thua mbi to. Më së miri është që kabllot të futen në gypa plastik të fiksuar në mure.

Në rastin e kompjuterëve laptop, pasi që ata kanë bateri, mund t'i përdorni në të gjitha pjesët e klasës varësisht nga nevojat e nxënësve.



KËSHILLA KRYESORE:

Nuk keni nevojë ta keni një kompjuter për çdo fëmijë. Është më mirë për shoqërimin e tyre që nxënësit të punojnë në çifte apo nga tre në një kompjuter. Në një aktivitet grupor, një nxënës mund ta marrë përgjegjësinë për të regjistruar në kompjuter.

Nëse keni vetëm një ose dy kompjuterë në klasë, mund të merreni vesh që nxënësit t'i shfrytëzojnë me radhë kompjuterët.

Laptopët mund të mbushen në prizat elektrike në klasë. Megjithatë, nëse keni një numër të laptopëve në shkollë, një zgjidhje më e mirë është një karrocë lëvizëse me mundësitë e mbushjes me energji. Këto karroca mund të përdoren për mbushjen e laptopëve si dhe për transportimin e tyre nëpër shkollë. Në shkollat e mëdha të cilat kanë shkallë, laptopët do të duhet të transportohen me dorë. Është ide e mirë që bartja e tyre nga zona e sigurt e ruajtjes të bëhet nëpër kuti plastike.

Basic Education Program i USAID-it është duke krijuar Klubet Teknike për Përkrahje të Nxënësve (KTPN) në shkollat ku USAID-i ka dhuruar kompjuterë. Këta janë nxënësit e klasave 7 deri 9 të cilët dalin vullnetarë për t'u kujdesur për kompjuterët e shkollës. Ata trajnohen nga Microsoft-i rreth mirëmbajtjes dhe kujdesit të kompjuterëve dhe marrin një çertifikatë nga ky program. Anëtarët e KTPN-së mund t'i shpërndajnë dhe t'i mbledhin laptopët çdo ditë nga klasat dhe gjithashtu t'ju ndihmojnë mësimdhënësve që t'i vendosin ata në klasë.

Kompjuterët janë shumë më të dobishëm në klasë kur janë të lidhur në internet. Ne siguroam qasje pa tela në internet në klasat tona apo afër klasave. Do të nevojitet një ekspert, për shembull mësimdhënësi i TI-së në shkollë, për ta testuar nivelin e sinjalit në laptopë. Laptopët më të rinj i kanë kartelat për internet pa tela të para-instaluar kështu që ju vetëm duhet t'i konfiguroni që të lidheni në internet pa tela. Në rastin e kompjuterëve të tavolinës mund t'i lidhni në internet me kabllot ose mund ta instaloni në ta një kartelë interneti pa tela.



KËSHILLA KRYESORE

Kërkoni nga drejtori i shkollës që ta formojë Klubin Teknik për Përkrahje të Nxënësve për t'u kujdesur për kompjuterët e shkollës. Ne jemi duke organizuar kurse për t'ju ndihmuar ta bëni këtë. Për të mësuar më shumë shih Faqet 55 dhe 56 në pjesën e pasme të këtij libri apo kontaktoni info@bep-ks.org

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Ka shumë mjete falas në internet për qëllime arsimore. Disa shembuj të softuerit dhe të burimeve falas në internet janë: Gcompris, <http://www.e-learningforkids.org/http://www.skool.ie/> <http://www.technologystudent.com>. Faqet më të dobishme të internetit janë të paraqitura në Shtojcën B. Ka shumë programe tjera kompjuterike që janë në dispozicion për kompjuterin në klasën tuaj, siç janë: GeoGebra, Microsoft Mathematics, FMSLogo, Google Earth, Microsoft WorldWide Telescope, ALICE, Google Sketchup etc. Instalimi dhe shfrytëzimi i këtyre programeve për qëllime arsimore është falas. Nëse dëshironi më shumë informata kontaktoni Basic Education Program të USAID-it në info@bep-ks.org ose vijoni njërin nga kurset tona (shih shtojcën A).



Qendra e shkencës është vendi ku nxënësit mund të hetojnë, vëzhgojnë, të kryejnë eksperimente dhe bëjnë hulumtime.

Ajo duhet të përmbajë bimë dhe objekte interesante të cilat mund t'i vëzhgojnë, dallojnë dhe klasifikojnë.

Qendra duhet të ketë materiale me të cilat nxënësit mund të eksperimentojnë dhe pajisje për t'ju ndihmuar që ta bëjnë këtë.

Më poshtë janë disa nga pajisjet dhe materialet themelore që mund t'i siguronin në qendrën e shkencës:

- bimë, rrënjë dhe fara;
- materiale natyrore si drunjë, gurë dhe lloje të ndryshme dheu;
- lloje të ndryshme të tekstilit (lesh, sintetikë, pambuk);
- materiale të ndryshme ndërtimore dhe çimento, allçi dhe ngjitës;
- letër, kartuç dhe materiale për vizatim dhe modelim;
- magnete të llojeve të ndryshme, dhe objekte të punuara nga metalet e ndryshme;
- xhama zmadhues, mikroskop, thjerrëza dhe një pasqyrë;
- tela elektrik, bateri, llamba dhe motor;
- shishe të pastra plastike dhe kontejnerë të tjerë;
- topa, lodra apo modele me rrota;
- balona dhe pompa;
- kontejnerë të formave dhe madhësive të ndryshme;
- pluhura si mielli, sheqeri, kripa, soda e bukës;
- qirinj (për përdorim nën mbikqyrjen e mësimdhënësit).

Çfarë duhet të përfshij në qendrën e shkencës?



KËSHILLA KRYESORE

Punoni me kolegët e tjerë për të mbledhur materiale të shkencës që ju nevojiten dhe ndani ato së bashku.



Këto materiale dhe pajisje nuk kanë nevojë të jenë të specializuara ose të shtrenjta. Ato mund të jenë materiale dhe objekte të përditshme që janë kudo në dispozicion. Për shembull, shishe e plastikës janë ideale për rritjen e fidaneve dhe bimëve. Në faqen 47 mund të lexoni më shumë rreth përdorimit të shisheve të plastikës në shkencë.



Ekspozita e Koleksionistëve

Nxënësit duhet të inkurajohen që të hulumtojnë çdo gjë që është rreth tyre dhe të mbledhin objekte interesante nga mjedis i tyre. Leni hapësirë në një dollap ose raft ku nxënësit mund t'i ekspozojnë gjërat interesante të cilat i gjejnë. Këto objekte mund të shfrytëzohen për diskutim në mësimet rreth koncepteve shkencore.



Fëmijët duhet të inkurajohen që t'i organizojnë, klasifikojnë dhe t'i përshkruajnë objektet siç do ta bënin shkencëtarët. Inkurajoni që t'i kërkojnë ngjashmëritë dhe dallimet dhe t'i përshkruajnë ato. Vendosni një listë përkatëse të fjalorit përshkruar në murin e fjalëve apo një poster për t'u ndihmuar nxënësve që t'i gjejnë shprehjet më të mira shkencore. Në qendër duhet të vendosen materiale për vizatim në mënyrë që nxënësit të vizatojnë atë çfarë shohin. Të gjithë shkencëtarët e mëdhenj të së kaluarës ishin edhe artist të shkëlqyer që mund të vizatonin me saktësi ato që zbulonin. Duke u rritur, nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i komunikojnë vërtetimet e tyre me saktësi dhe të ofrojnë detaje gojshme, me shkrim dhe përmes vizatimeve.



Mikroskopët e llojit të vjetër nga qelqi janë shumë të vështirë për shfrytëzim nga fëmijët e vegjël. Më së miri është që të investohet në një mikroskop elektronik që mund ta përdorni me një kompjuter. Kjo është ajo që sot përdorin shkencëtarët e vërtetë. Mikroskopët themelor elektronik mund të jenë po aq të lirë, ose edhe më të lirë se sa mikroskopët e njëjtë nga qelqi.

Përparësitë janë të shumta:

- Grupet e nxënësve mund ta shohin imazhin në ekranin e kompjuterit;
- Mund të bëjnë fotografi të asaj çfarë shohin dhe t'i përfshijnë ato në raportet e tyre;
- Arsimitari mund ta përdor një projektor për t'ia prezantuar imazhet tërë klasës.

Mund të përdoren kamerat e zakonshme (ose telefonat celular) për të bërë fotografi të eksperimenteve për qëllime raportimi ose mund të merren jashtë në natyrë për t'i regjistruar objektet dhe dukuritë natyrore.

Përvojat praktike në qendrën e shkencës u ndihmojnë fëmijëve që t'i kuptojnë konceptet shkencore si dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë e procesit siç janë: vëzhgimi, krahasimi, kundërshtimi, matja, komunikimi, regjistrimi, organizimi dhe interpretimi i të dhënave, supozimi, parashikimi dhe krijimi i hipotezave.

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Basic Education Program i USAID-it organizon kurse shkencore për mësimdhënësit në komunat partnere. GIZ gjithashtu organizon kurse shkencore. Për më shumë informata, shih Shtojcën B në fund të këtij libri.



Nxënësit duhet të trajnohen për procesin shkencor:

- **Vrojtimi (vëzhgimi);**
- **Pyetjet**
- **Parashikimi (Hipotezat & teoritë)**
- **Eksperimentimi (Kontrollimi i variablave)**
- **Vlerësimi**

Në qendër të shkencës është eksperimenti. Nxënësve duhet t'u ofrohet mundësia për t'i studiuar dhe vështruar objektet e ekspozuara në qendrën e shkencës. Mësimdhënësi duhet t'i udhëheq nxënësit dhe t'i strukturojë hulumtimet. Mësimdhënësit mund t'i inkurajojnë fëmijët për të bërë pyetje, për të krijuar mënyra për t'u përgjigjur atyre, dhe për t'ua prezantuar rezultatet e tyre shokëve të klasës.

Tabelat e ekspozimit në qendrën e shkencës duhet të ndryshohen në atë mënyrë që të përshtaten me përmbajtjen e plan-programit. Nëse përqëndrimi është mbi qeniet e gjalla, mund të studiohen insektet dhe krijesat tjera të vogla. Nëse përqëndrimi është mbi strukturat dhe forcat, atëherë mekanizmat interesant siç janë pjesët e brendshme të një pajisjeje të kuzhinës apo të një lodre do t'u ndihmojnë nxënësve t'i kuptojnë dhëmbëzorët dhe transmisionin. Duke u zhvilluar njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë e nxënësve, ata duhet të jenë në gjendje t'i komunikojnë këndvështrimet e tyre me saktësi të lartë dhe në detaje gojarisht dhe në formë të shkruar, me fotografi, përmes prezantimeve me kompjuter dhe në vizatimet e tyre. Vizatimi i objekteve reale i përmirëson shkathtësitë e vështrimit tek nxënësit.



Shkenca moderne në botën e vërtetë nuk zhvillohet nga individët, por nga grupet që punojnë së bashku, duke bashkëpunuar për të diskutuar dhe krahasuar rezultatet.

Shkenca në klasë gjithashtu duhet t'i përfshijë aktivitetet bashkëpunuese dhe diskutimet në grup.

Mësimdhënësit janë shembuj/modele të rëndësishme dhe janë ata që angazhohen me entuziazëm në hulumtim me nxënësit e tyre, të cilët iu përgjigjen dhe i respektojnë pyetjet dhe komentet e nxënësve dhe që i mbjellin tek nxënësit e tyre këtotribute të njëjta shkencore dhe personale.



Gjatë renovimit të klasës në shkollën fillore të mesme të ulët "Gjergj Fishta" në Prishtinë, ekspertët tanë kanë punuar me mësimdhënësit dhe nxënësit për të demonstruar një sërë aktiviteteve shkencore, ata punuan me nxënësit e klasës së dytë dhe asaj të pestë të cilët e ndajnë të njëjtën klasë. Gjatë këtyre aktiviteteve, nxënësit patën mundësi të mësojnë më shumë për siguri në internet, të hulumtojnë mikro-botën me një mikroskop elektronik, t'i zbulojnë ndryshimet e temperaturës duke përdorur sondat elektronike, t'i hulumtojnë modelet përsëritëse të numrave me një kalkulatorë, të shkruajnë programe kompjuterike duke përdorur gjuhën e programimit LOGO dhe të bëjnë xhirime filmike të këtyre aktiviteteve me një video kamerë të vogël.



Për t'i ndihmuar nxënësit që të mësojnë fjalorin shkencor dhe të përdorin fjalë teknike në raportet e tyre, bëni një mur të fjalëve ose poster në këndin tuaj të shkencës me fjalët përkatëse për moshën e nxënësve dhe konceptet shkencore që ata janë duke i mësuar me plan-program.

Nxënësit duhet t'i identifikojnë dhe t'i shkruajnë vet kartelat e fjalëve. Kjo do t'u ndihmojë atyre që t'i mësojnë fjalët dhe të ndjejnë pronësinë mbi ato që prezantohen.

Fëmijëve në klasat e ulëta fillore duhet t'u ofrohet përvoja shkencore që është e bazuar në hulumtim dhe që përfshin zgjidhjen teknologjike të problemeve, dhe të integrohet, ku është e mundur, me disiplinat tjera si matematika, gjeografia dhe me të nxënit në lidhje me mjedisin. Më poshtë është një eksperiment i kryer nga fëmijët gjatë renovimit tonë në shkollën "Gjergj Fishta". Edhe pse ka të bëjë me konceptin shkencor të nxehtësisë dhe temperaturës ai gjithashtu i mëson nxënësit në lidhje me rëndësinë e izolimit për të parandaluar humbjen e nxehtësisë, përfshin përdorimin e TIK-ut dhe i ndihmon nxënësit ta vlerësojnë përdorimin praktik të diagrameve. Kur këto tema të diskutohen në orët tjera, nxënësit do t'i kuptojnë ato më mirë.



Ramadan Ruhani,
nxënës i klasës së 5-të,
Shkolla "Gjergj Fishta".

"Me ndihmën e USAID-it, atmosfera në klasë ka ndryshuar. Ajo nuk është më e thjeshtë, ajo është e digjitalizuar. Klasa jonë ka marrë pjesë në eksperimente dhe tani ka kompjuterë."

Për programet televizive, Basic Education Program i USAID-it renovoji dy klasa të përqendruara në fusha të caktuara.



Në shtator të vitit 2011, një ekip i renovimit të klasave, duke përfshirë edhe ekspertët e arsimit, teknologjisë, renovimit të klasave, një prezantues televiziv dhe ekipin e filmimit, udhëtoi drejt shkollës fillore të mesme të ulët "Lidhja e Prizrenit" në Deçan, për t'i filluar xhirimet e transformimit të një klase tradicionale në klasë të përqendruar në teknologji.

Transformimi u bë nga prindërit, mësuesit dhe nxënësit me mbështetjen e ekipit "të renovimit". Klasa e përzgjedhur ishte një klasë e zakonshme e cila do të përdoret si një klasë praktike për mësimin e teknologjisë, por gjithashtu do të përdoret si një klasë me qëllime të përgjithshme të mësimdhënies.

Sandie Kendal - eksperte e teknologjisë nga Mbretëria e Bashkuar, ishte këshilltarja kryesore në këtë renovim. Një fasilitator i programit kishte punuar me nxënësit e shkollës për ta krijuar modelin elektrik të kolovajzës.



Në tetor, një program televiziv i "Renovimit të klasës" ishte filmuar në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Naim Frashëri" në fshatin Zaskok, në komunën e Ferizajit. Fokusi i programit të asaj jave ishte renovimi i një klase të zakonshme për ta përdorur si klasë shkence me shumë qëllime. Jeff Nowak - këshilltar shkencor nga SHBA, ishte këshilltari kryesor në këtë renovim.

Jeff gjithashtu punoi me nxënësit, mësuesit dhe prindërit për t'i ndihmuar ata që të krijojnë mjete ndihmëse të mësimdhënies dhe mësimnxënies me kosto të ulët nga materialet e përditshme. Nxënësit pastaj i shfrytëzuan ato në eksperimentet dhe aktivitetet shkencore. Në ditën e fundit të xhirimit një fasilitator i programit punoi me nxënësit për ta krijuar "Makinën Lëvizëse me Energji", ku katër grupe përdorën materiale të ricikluar dhe burimet e sjellura nga shtëpitë e tyre për t'i krijuar katër module, të cilat kur bashkohen formojnë një pajisje për kontrollimin e energjisë dhe lëvizjes.

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË? Lexoni më tepër rreth këtyre aktiviteteve shkencore në faqet në vijim.



Unë e kuptoj pse duhet rregulluar orenditë për aktivitetet në grup, por pse është i rëndësishëm ekspozimi?



Ekspozimet nuk janë vetëm për ta bërë dhomën më tërheqëse. Ato mund t'i ndihmojnë nxënësit në nxënie.

Çfarë mund të bëjmë?

- Krijoni ekspozime që janë të rëndësishme për plan-programin;
- Ekspozoni punimet e nxënësve që rrjedhin nga aktivitetet në klasë;
- Ndryshoni shpesh ekspozimet.

Ekspozimet duhet të kenë **një lidhje kuptimplotë me plan-programin** - ato duhet të jenë mjete efektive të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Informata duhet të lidhet, të buroj, dhe të zgjerohet përtej njohurive të nxënësve në lidhje me temat që janë duke u studiuar.

Krijoni ekspozime që i paraqesin **përpyqjet e nxënësve për të nxënë, jo vetëm për vetësimin** e njohurive dhe shkathtësive. Ekspozimet duhet ta bëjnë çdo fëmijë të ndjehet i çmuar, parvarësisht nga aftësitë e tyre akademike dhe artistike. Duke krijuar ekspozime të cilat i njohin përpyqjet më tepër se përsosmërinë, fëmijët kuptojnë më mirë se të nxënësit është një proces i rritjes, e jo vetëm një çështje e përvetësimit. Ekspozimet ofrojnë një mundësi për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për të mësuar se si ta çmojmë punën e të tjerëve, duke kultivuar ndjeshmërinë, respektin, dhe një ndjenjë të fortë të komunitetit të klasës.

Përkujdesuni që gjithmonë të ketë një **ekspozim që reflekton përpyqjet e të gjithëve** në klasë. Këto ekspozime e forcojnë ndjenjën e përkatësisë tek secili fëmijë dhe kanë një efekt të fuqishëm në krijimin e një komuniteti të nxënësve.

Ndërroni ekspozimet. Sigurohuni që punimet e fëmijëve të ndërrohen mjaft shpesh për t'i mbajtur ekspozimet relevante me plan-programin dhe për t'i parandaluar ato nga të bërit 'monoton'.

Mbani hapësirën e ekspozimit **të rregulluar mirë**. Disa ekspozime, siç janë ato që rezultojnë nga një aktivitet në klasë e që përfundojnë me një Turne në Galeri, mund të hiqen nga muri pas atij mësimi përveç nëse kanë lidhje me një mësim tjetër në vijim.

Muret e fjalëve për klasat 6-9

Në faqen 26 kemi diskutuar rreth murit të fjalëve për klasat 1-5. Sidoqoftë, mësuesit e të gjitha klasave mund t'i përdorin muret e fjalëve për fjalët shkencore, fjalët e studimeve shoqërore dhe fjalët e matematikës. Disa mësuesit i radhisin fjalët në mur në mënyrë alfabetike; të tjerët i radhisin ato sipas kategorive. Në orët e historisë, ju mund t'i radhisni sipas ngjarjeve. Në matematikë apo shkencë, mund t'i radhisni sipas sistemeve. Përfshini si më poshtë:

- fjalët që shpesh gërmëzohen keq;
- fjalët në lidhje me përmbajtjen;
- shprehjet teknike;
- fjalët më të sofistikuara që mund të zëvendësohen me fjalët që përdoren më shpesh, për ta zgjeruar fondin e fjalëve tek nxënësit.

KËSHILLA KRYESORE PËR SHFRYTËZIMIN E MURIT TË FJALËVE

Muret e fjalëve duhet të gjenerohen nga nxënësit, e jo të përgatiten komercialisht.

Për shkak se nxënësit vet i ndërtojnë muret e fjalëve, ata e marrin përsipër pronësinë e tyre dhe e çmojnë përdorimin e tyre.

- Informatat e reja duhet të shtohen në baza të rregullta - qoftë edhe ditore;
- Më tepër duhet të shfrytëzohen materialet në lidhje me përmbajtjen nga plan-programi, se sa fjalët e zgjedhura rastësisht;
- Nxënësit duhet t'i referohen më shpesh murit të fjalëve në mënyrë që të arrijnë ta kuptojnë dhe ta shohin rëndësinë e tyre;
- Muret e fjalëve janë një përpyqje grupore - lejon nxënësit të bëjnë sugjerime rreth përmbajtjes.

Shkolla ime nuk ka laborator shkencor. Si mund të jap mësim nga shkencë në një klasë të zakonshme?



Ju mund ta shndërroni çdo klasë të zakonshme në një klasë shkencë.

Gjërat themelore që ju nevojiten janë:

1. Vendet për ruajtje (raftet dhe dollapët për pajisje e material shpenzues);
2. Tavolina pune që mund të zhvendosen dhe të riorganizohen sipas dëshirës;
3. Tabelat e ekspozimit dhe raftet për ta ruajtur dhe paraqitur punën e nxënësve;
4. Qasjen në ujë; dhe
5. Priza elektrike për shfrytëzimin e TIK-ut dhe pajisjeve elektrike.

Renovimi i klasës në shkollën fillore të mesme të ulët "Naim Frashëri" në Zaskok, Ferizaj



PARA



PAS

Eksperti ynë nga SHBA, Jeff Nowak, me kënaqësi punoi me nxënësit në Zaskok dhe shprehi admirim për reagimin e nxënësve.

"Kur përfundimisht ishim në gjendje që t'i sillnim nxënësit për t'ua treguar klasën e re, emocionet dhe energjia e tyre ishin aq të mëdha sa që të gjithë patëm ndjenjën se mund të ngriheshim lart si shqiponjat. Të jesh në gjendje t'u tregosh nxënësve se gati të gjitha materialet ishin dhuruar nga bizneset lokale dashamirëse dhe anëtarët e komunitetit të cilët duan arsimim më të mirë për ta, në partneritet me USAID-in, ishte me të vërtetë shpërblyese dhe më ka bërë shumë krenar."

DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Basic Education Program i USAID-it është duke organizuar kurse për mësimdhënësit e shkencës në komunitatet partnere. Për më shumë informata rreth kurseve të organizuara nga Basic Education Program, shiko Shtojcën A në fund të këtij libri.



Vendi për ruajtje

Në shkollën "Naim Frashëri", kemi bërë shumë raftet nga tavolinat e ricikluara. Të gjitha materialet dhe pajisjet e blera ose të mbledhura për përdorim në shkencë duhet të ruhen në kuti ose në kontejnerë dhe të etiketohen në mënyrë që të jenë të sigurt dhe të jenë lehtë në dispozicion kur u nevojiten nxënësve. Gjithashtu u siguruan vendet për ruajtjen e punimeve të papërfunduara të projekteve të nxënësve.

Tavolinat lëvizëse

Tavolinat statike përdoren nga punëtorët e zyrës dhe jo nga shkencëtarët. Në klasën e përqendruar në shkencë, më të përshtatshme dhe më të dobishme janë tavolinat e punës.

Tavolinat e punës ofrojnë hapësirë për eksperimente praktike shkencore dhe aktivitete në grup. Ne i projektua dimensionet e tavolinave me qëllim që ato të organizohen në mënyra të ndryshme për t'iu përshtatur aktiviteteve mësimore.



Ekspozimi

Në muret e klasës instalua tabela për ekspozimin e posterëve shkencor dhe fotografive, si dhe shkrimeve dhe vizatimeve të nxënësve.

Gjithashtu ofruam shumë raftet në klasë për t'i ekspozuar objektet dhe pajisjet interesante dhe modelet shkencore të punuara nga nxënësit. Në mur e ngjyrosëm një drejtkëndësh të bardhë për prezantimet me projektor.

Qasja në ujë

Nxënësve u nevojitet qasja në ujë. Nëse nuk ka çezma në klasë, mund të ketë nevojë për kontejnerë uji. Qasja në frigorifer për akull është gjithashtu e dobishme, por ky nuk duhet të jetë domosdoshmërisht në klasë.

Në shkollën "Naim Frashëri", lavamanët ishin në dispozicionin tonë për shfrytëzim brenda shkollës. Gjithashtu ka pasur edhe çezma uji të vendosura jashtë në oborrin e shkollës. Kur moti është i mirë, aktivitetet që përfshijnë ujin mund të zhvillohen edhe jashtë ndërtesës së shkollës.



Kompjuterët në klasën e përqendruar në shkencë

Kompjuteri është i domosdoshëm në klasën bashkëkohore të shkencës për punën me sensorët, sondat, kamerat dhe mikroskopët elektronik. Më së miri është të investohet në një mikroskop elektronik që mund ta përdorni me një kompjuter. Kjo është ajo që sot përdorin shkencëtarët e vërtetë. Mikroskopët themelor elektronik nuk janë të shtrenjtë dhe mund të shfrytëzohen nga të gjithë në shkollë. Në shkollën "Naim Frashëri" për ta prezantuar punën e nxënësve është përdorur kompjuteri dhe një projektor. Kompjuterët mund të përdoren nga nxënësit për të shkruar raporte, vizatuar diagrame dhe për ruajtjen dhe analizimin e të dhënave. Së fundi ekziston një thesar i tërë i njohurive shkencore që është në dispozicion në internet, për të mos i përmendur Google Earth dhe Planetariumet.



Makina ekologjike

Duke zbatuar ligjet e fizikës dhe njohuritë për makinat e thjeshta, nxënësit (kandidatët) duhet të ndërtojnë një makineri të përbërë nga disa makina të thjeshta ose nënstacione të makinës, sipas Rube Goldberg, që kryejnë së paku 10 veprime ashtu që me makinën (veprimin) e fundit ta kryejë një (dy ose tri) veprim të zgjedhur të thjeshtë, pra, të arrij qëllimin.

Çdo grup duhet t'i përmbahet këtyre rregullave:


- Duhet të kryhen së paku 10 veprime,
- Duhet të përdoren së paku 4 makina të thjeshta të ndryshme,
- E njëjta makinë nuk bën të përsëritet më shumë se 2 herë,
- E tërë fusha e shtrirjes së makinerisë duhet të zërë sipërfaqe deri në 1.5 x 1.5 x 1.5 m,
- Makinaria vendoset në një tabelë vertikale me mundësi të qëndrimit për një kohë të gjatë,
- Koha e punës e tërë makinerisë duhet të jetë në minimum 1 dhe maksimum 5 minuta,
- Nga makinat e thjeshta që duhet patjetër të përdoren nga një herë janë rrotulla, rrafshi i pjerrët dhe llozi.
- Nuk guxon t'i lëndojë njerëzit,
- Mjetet e përdorura duhet të jenë riciklime,
- Nuk bën që pas vetes të leni mbeturina, por mjedisi duhet të kthehet në gjendjen si ka qenë para fillimit të punës,
- Të ndërtojmë një makinë vepruese të gjelbër, ku përmes hapave të caktuar energjia bartet gjatë kohës, përmes sa më shumë veprimeve, brenda 5 minutash.

Në këtë aktivitet mund të përfshihen shumë njësi mësimore të fizikës dhe lëndëve tjera. Kështu nga fizika mund të mësohen këto: ekuilibri i trupave, llojet e ekuilibrit, qendra e rëndesës së trupave, momenti i forcës, llozi në ekuilibër, rendimenti i makinave të thjeshta dhe forca e fërkimit.

Hetimi i llojeve të tokës me një sedimentator

Në shkollën "Naim Frashëri", nxënësit mblodhën mostrat e dheut rreth shkollës dhe përdorën shishe plastike dylitërshe për t'i bërë Sedimentatorët.

Ata mbushën përafërsisht gjysmën e shishes me dhe, e pastaj pjesën tjetër të shishes e mbushën me ujë. Pas shkundjes së vullshme të shishes, e lejuan që dheu të fundërrëjë. Kur ndodhi kjo, përbërja e dheut mund të shihej dhe krahasohej me lehtësi me mostrat tjera.



Mbijetesa e vezës së hedhur

Ky projekt përfshin furnizimin e grupeve të nxënësve me vezë të freskëta, një numër të caktuar të fytëzave, dhe një sasi të caktuar të shiritit. Nga nxënësit kërkohet që ta bëjnë një enë mbrojtëse që do t'i mbrojë vezët nga thyerja kur ato të bien nga një lartësi e caktuar. Dy të tretat e vezës duhet të jenë të dukshme në çdo kohë dhe veza duhet të jetë në gjendje që të tërhiqet lehtë nga ena. Lëshoni enën nga tri lartësi të ndryshme. Vezët që nuk plasariten mbijetojnë!


Konceptet shkencore përfshijnë:

- Rënie e lirë, përshpejtimin për shkak të gravitacionit dhe shpejtësinë
- Goditja/Stresi (S) = Forca/Sipërfaqja, Elasticiteti.

Zhytësi Kartezian!

Secili grup i nxënësve kishte një shishe dylitërshe, një rrëmojcë për dhëmbë, mbajtës letrash, një fytëz dhe pak argjilë. Nevojitet edhe uji. Nxënësit sfidohen për të krijuar një pajisje duke i përdorur këto materiale që mund të shkojë lart e poshtë nëpër shishe, nën kontrollin e tyre. Nxënësve u ishte prezantuar një pajisje e tillë pune, dhe ata vënë re fluskën e ajrit që lëvizte në fytëz. Përmes provave dhe dështimeve ata krijuan zhytës që punonin. Konceptet shkencore përfshijnë:

- dendësinë, gjendjet agregate të materies, vetitë e lëngjeve dhe gazrave, dhe gravitacionin.



Lansues raketash me shishe

Ky projekt përfshin mbushjen me ujë të një shisheje dylitërshe, futjen e ajrit në shishe, dhe lansimin e saj në ajër. Nga grupet e nxënësve ishte kërkuar që ta modifikonin shishen në mënyrë që ajo të fluturonte sa më drejtë dhe të qëndronte në ajër sa më gjatë para se të kthehej përsëri në tokë. Raporti ideal i presionit të ajrit kundrejt ujit ishte studiuar dhe shënuar me diagram. Konceptet shkencore përfshijnë: • Ligjin e 3-të të Njutonit – 1) Inercioni, 2) Forca= Masa X Përshpejtimi, dhe 3) Për çdo veprim ka një prapaveprim të barabartë dhe të kundërt • Lëvizja e predhës - Lëvizja në të cilën hedhet ose projektohet një trup quhet lëvizje e predhës. Shtegu i ndjekur nga një predhë quhet trajektorja e saj, e cila është e ndikuar drejtpërdrejtë nga gravitacioni. • Vetitë e trupave të ngurtë, lëngjeve dhe gazrave gjithashtu mund të studiohen. Lëngjet dhe trupat e ngurtë janë në thelb të pakompresueshëm, ndërsa ajri mund të kompresohet.

Bërja e akullores

Secili grup i nxënësve kishte një shishe dylitërshe, një rrëmojcë për dhëmbë, mbajtës letrash, një fytëz dhe pak argjilë. Nevojitet edhe uji. Nxënësit sfidohen për të krijuar një pajisje duke i përdorur këto materiale që mund të shkojë lart e poshtë nëpër shishe, nën kontrollin e tyre. Nxënësve u ishte prezantuar një pajisje e tillë pune, dhe ata vënë re fluskën e ajrit që lëvizte në fytëz. Përmes provave dhe dështimeve ata krijuan zhytës që punonin. Konceptet shkencore përfshijnë: • dendësinë, gjendjet agregate të materies, vetitë e lëngjeve dhe gazrave, dhe gravitacionin. • Vetitë e trupave të ngurtë, lëngjeve dhe gazrave gjithashtu mund të studiohen. Lëngjet dhe trupat e ngurtë janë në thelb të pakompresueshëm, ndërsa ajri mund të kompresohet.






Teknologjia ka ndryshuar me shpejtësi në pesëdhjetë vitet e fundit dhe shkollat duhet të përkujdesen që nxënësit e tyre të pajisen me shkathtësitë, njohuritë dhe të kuptuarit të cilat do t'u nevojiten për punësimin e tyre në të ardhmen.

Qasja e sfidës së dizajnit

Qasja e dizajnit ndaj të nxënimit jo vetëm që do t'i zhvillojë shkathtësitë në ndërtimin praktik por edhe kompetencat dhe qëndrimet që do të jenë thelbësore për vendin e punës të së ardhmes. Mësimdhënia tradicionale e teknologjisë është e varur nga librat shkollore dhe aty ku aktivitetet praktike zhvillohen në shkollë ato janë zakonisht të udhëhequra nga mësimdhënësi dhe nuk iniciohen nga nxënësit. Qasja e sfidës së dizajnit ka nxënësin në qendër, dhe ata duhet të hartojnë një zgjidhje për një sfidë dhe ta modelojnë zgjidhjen e tyre në 3D dhe jo vetëm të bëjnë skica në letër.



Mësimdhënia tradicionale e teknologjisë	Qasja e Sfidës së Dizajnit ndaj mësimdhënies
Është kryesisht teorike	Është praktike
Mëson shkathtësitë tradicionale artizanale	Mësohen shkathtësitë projektuese
Detyra individuale, punohet vetëm	Inkurajohet puna ekipore ose puna në çifte
Nxënësit përsërisin të njëjtin produkt	Zgjidhjet janë të ndryshme, por plotësojnë kriteret ose specifikimet
Theksohet cilësia e produktit përfundimtar	Theksohet cilësia e të menduarit dhe e kreativitetit.



Për arsye se qasja e sfidës së dizajnit është praktike, klasa bashkëkohore e përqendruar në teknologji duhet të rregullohet si një punëtori, me mjete dhe materiale që janë në dispozicion. Sipërfaqet e punës duhet të jenë mjaft të mëdha për qarqe, mekanizma dhe struktura praktike.



Raftet për ruajtjen dhe ekspozimin e punimeve të nxënësve


Për shkak se qasja e sfidës së dizajnit është shumë praktike, dhe aktivitetet mund të vazhdojnë për një numër të njësive mësimore, klasa e përqendruar në teknologji ka nevojë për shumë hapësirë për ruajtjen e punimeve të nxënësve gjatë procesit të projektimit.

Hapësira do të jetë gjithashtu e nevojshme për ekspozimin e punimeve të nxënësve pas përfundimit të tyre. Mësimdhënësit gjithashtu mund t'i paraqesin mekanizmat dhe strukturat për qëllime demonstrimi.

Vendi për ruajtjen e materialeve dhe pajisjeve të teknologjisë

Duhet të ketë vend për gjithçka dhe çdo gjë duhet të jetë në vendin e vet.

Gjësendet e vogla duhet të mbahen në kuti të etiketuara qartë. Pas çdo aktiviteti nxënësit duhet të përkujdesen që mjetet, materialet dhe pajisjet e teknologjisë të vendosen në vendet e tyre.



Të punuarit së bashku

Të nxënimit përmes sfidës së dizajnit mbështet zhvillimin e shkathtësive për jetë dhe punën e bazuar në aktivitetet bashkëpunuese, siç janë aktivitetet në çifte dhe grupe. Këto aktivitete nuk mund të realizohen në një klasë tradicionale në të cilën tavolinat janë të radhitura në rradhë.

Ka disa mënyra për vendosjen e tavolinave me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve grupore dhe një prej tyre mund të jetë në formë rrethore. Hapësira në klasë duhet të shfrytëzohet mirë në mënyrë që nxënësit dhe mësimdhënësit të mund të lëvizin pa vështirësi.

Basic Education Program i USAID-it është duke ofruar pajisje të teknologjisë për shkolla përmes programit të vet trajnues për mësimdhënësit e teknologjisë.

Pajisjet përfshijnë robotët dhe krahët robotik, qarqet elektronike dhe një pako të veglave dhe materialeve për teknologji themelore.



DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Shikoni faqen tonë: www.bep-ks.org, ose na shkruani në bepinfo@fhi360.org

Nxënësit mund të përdorin materiale dhe teknika të thjeshta për të bërë mekanizma, struktura dhe qarqe.



Nxënësit mund të bëjnë pajisje elektrike duke i përdorur pajisjet themelore, siç janë telat elektrik, bateritë, elektromotorët, etj. Kompjuteri mund të përdoret për dizajnim duke shfrytëzuar softuer falas siç është ai "Alice". Në klasë mund ta përdorim kompjuterin si një kontrollues dhe mund të dizajnojmë programe për t'i kontrolluar dhe monitoruar pajisjet që kemi krijuar. Megjithatë ne kemi nevojë për një pjesë shtesë të pajisjes që duhet të lidhet me kompjuterin në mënyrë që t'i përdorim pajisjet periferike dhe sensorët që kemi krijuar.

Kjo pajisje është kutia e kontrollit ...



Muri i projektimit

Nxënësit mund t'i prezantojnë dizajnimet e tyre fillestare për diskutim nga i gjithë grupi. Kjo mund të bëhet nëpërmjet të kompjuterit nëse është në dispozicion një projektor.

Mësimdhënësi gjithashtu mund të përdorë edhe burime nga interneti siç është www.technologystudent.com për t'i demonstruar konceptet për të gjithë nxënësit. Një pjesë e murit duhet të jetë me ngjyrë të bardhë për shkak të prezantimeve me projektor.



Më poshtë janë fotot nga Klasa e përqendruar në Teknologji në shkollën fillore të mesme të ulët "Bedri Gjinaj", në Mitrovicë.



Kornizat e forta për pajisje mund të bëhen thjeshtë nga druri në formë shiriti të lidhur me kartuç në formë trekëndëshi.




Druri katror 10mm prehet dhe bashkohet lehtë duke përdorur një mbajtëse dhe sharrë të vogël.



Rrotat mund të prehen me lehtësi nga kompensata (shpërplaka) e drurit duke përdorur një sharrë vrimash.



Kunjat e drurit mund të përdoren si boshte. Shufra druri drejt-këndëshe 20mm x 5mm mund të shpohen për t'i mbajtur boshtet dhe të formësohen me një limë.



DËSHIRONI TË MËSONI MË SHUMË?

Basic Education Program i USAID-it është duke organizuar kurse për mësimdhënësit e Teknologjisë në komunat partnere. Për më shumë informata shiko Shtojcën A në fund të këtij libri.

EKIPI

Ne shpresojmë që ju do të argëtoheni duke e bërë renovimin e klasës suaj, po aq sa jemi argëtuar edhe ne.



XHEVDETI



BAHRIA



SAHADETJA



JETONI



RREZARTA



PETRITI



ARSIMI



ARLINDA



ARMENDI, BEHARI



NERTILA, BURIMI



FLORINA, HANA, SUZANA



VALMIRA, FLAURIE



KEITH



ARDIANI



BASHKIMI, LIRIDONI



JEFF



NEHATI



SANDIE

Suksese nga Ekipi i Renovimit të Klasave i Basic Education Program!

SHTOJCA A:

KURSET QË ORGANIZOHEN NGA BASIC EDUCATION PROGRAM I USAID-IT

Në kohën kur shkruhej kjo, Basic Education Program ka nënshkruar marrëveshje me komunat e mëposhtme:

1. Deçan	7. Mamushë	13. Rahovec
2. Glogoc	8. Mitrovicë	14. Shtërpce
3. Gjakovë	9. Novobërdë	15. Vushtrri
4. Istog	10. Obiliq	16. Shtime
5. Kllokot	11. Prishtinë	17. Suharekë
6. Malishevë	12. Podujevë	

Qendrat për Ngritje Profesionale, ku do të mbahen kurset e Basic Education Program janë themeluar në të gjitha këto komuna. Është planifikuar të arrihen marrëveshje me pesë komuna tjera në vitin 2012 dhe të ofrohen Qendra për Ngritje Profesionale në këto lokacione.

Tabela më poshtë i radhit kurset e planifikuara nga ana e Basic Education Program nga viti 2012 deri në fund të programit, në shtator të vitit 2015.

Kurset e Basic Education Program të parapara të fillojnë në vitin 2012		
Emërtimi	Pjesëmarrësit	Detajet
Shkencë	Mësimdhënësit e shkencës	Ky kurs do t'ju ndihmojë mësimdhënësve të shkencës që ta modernizojnë lëndën e tyre dhe ta fusin atë në shekullin 21. Ai përqendrohet në eksperimente dhe demonstrime praktike duke përdorur materiale me kosto të ulët, por kursi gjithashtu përfshin kompjuterët dhe teknologjinë moderne, si mikroskopët elektronik, sondat dhe sensorët. Shkollat e mësimdhënësve të cilët marrin pjesë në këtë kurs mund të pranojnë një pako të pajisjeve shkencore bashkëkohore.
Teknologji	Mësimdhënësit e teknologjisë	Ky kurs do t'ju ndihmojë mësimdhënësve të teknologjisë që ta modernizojnë lëndën e tyre dhe ta fusin atë në shekullin 21. Ai përqendrohet në projektimin praktik duke përdorur materiale me kosto të ulët, por kursi gjithashtu përfshin edhe shfrytëzimin e TIK në teknologjinë e kontrollit, robotikë, animacion dhe video. Shkollat e mësimdhënësve të cilët marrin pjesë në këtë kurs mund të pranojnë një pako të materialeve dhe pajisjeve për kabinetet e tyre të teknologjisë.
Mësimnxënia në lidhje me mjedisin	Mësimdhënësit e shkencës dhe gjeografisë	Ky kurs do t'ju ndihmojë mësimdhënësve të shkencës në mësimdhënien e koncepteve mjedisore në mësimet e tyre. Ai përqendrohet në të nxënit aktiv dhe se si mund të punojnë nxënësit pozitivisht për ta përmirësuar mjedisin e tyre lokal, për shembull përmes riciklimit.
Gjuha angleze	Mësimdhënësit e gjuhës angleze	Ky kurs do të përqendrohet në shfrytëzimin e të nxënit aktiv dhe TIK në mësimin e gjuhës angleze. Do të ketë një përqendrim në përdorimin e videos si një mënyrë për nxënësit që ta ushtrojnë një gjuhë të huaj dhe t'i përmirësojnë aftësitë e tyre komunikuese.
Klubet Teknikë për Përkrahje të Nxënësve, KTPN	Mësimdhënësit nga shkollat që kanë kompjuterë	Një mësimdhënësi të TIK-ut dhe një mësimdhënësi tjetër të emëruar nga çdo shkollë do t'u ofrohen trajnime teknike rreth përkujdesjes dhe mirëmbajtjes së kompjuterëve dhe do të mësojnë se si ta formojnë një Klub Teknik për Përkrahje të Nxënësve: një grup të nxënësve nga klasa e 7-të deri te klasa e 9-të të cilët do të ndihmojnë rreth përkujdesjes dhe shpërndarjes së kompjuterëve në shkollë. Ky kurs është organizuar në bashkëpunim me Partnerët e Microsoft-it në Mësimnxënie.

Krijimi i mjedis-eve efektive të nxënit	Mësimdhënësit e klasave 1 - 5	Ky kurs synon mësimdhënësit të cilët duan t'i modernizojnë klasat e tyre dhe përfshin tema si të nxënit aktiv, puna në grupe dhe mësimnxënia e diferencuar. Kursi veçanërisht synon mësimdhënësit që duan ta organizojnë një renovim të klasës.
Matematikë	Mësimdhënësit e matematikës	Ky do të jetë një kurs praktik që i demonstroi aktivitetet dhe teknologjinë arsimore për klasat 6 - 9, të cilat kanë për qëllim: <ul style="list-style-type: none"> • zhvillimin e shkathtësive të nxënësve në zgjidhjen e problemeve, të menduarit logjik, kreativitet, punë ekipore dhe TIK; • t'u ndihmojnë atyre ta shohin rëndësinë e matematikës për jetën dhe të ardhmen e tyre; • t'i thellojë njohuritë e tyre matematikore; dhe • ta rrisë interesimin e tyre për matematikën.
Matematikë	Mësimdhënësit e klasave 1 - 5	Ky është një kurs i ngjashëm me atë më sipër, por është i paraparë për mësimdhënësit e klasave 1 - 5.
Lexim	Mësimdhënësit e klasave 1 - 5	Ky kurs do t'i demonstrojë teknikat për t'i ndihmuar nxënësit të mësojnë të le për nxënie gjatë gjithë jetës.
Vlerësimi shkollor	Të gjithë mësimdhënësit	Ky kurs i informon mësimdhënësit në lidhje me "Vlerësimin për të Nxënit" dhe demonstroi teknikat për t'u ndihmuar mësimdhënësve që të vlerësojnë se çfarë janë duke mësuar nxënësit nga secili mësim, dhe për t'u ndihmuar nxënësve që ta kontrollojnë vet të nxënit e tyre.
Standardet e Ngritjes Profesionale	Edukatorët e përzgjedhur	Ky kurs është për mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta dhe edukatorët e tjerë që janë identifikuar si fasilitatorë dhe mentorë të mundshëm.
Këshillat drejtues të shkollave	Përfaqësuesit e këshillave drejtues të shkollave	Ky kurs do t'i informojë pjesëmarrësit për detyrimet ligjore dhe përgjegjësitë e këshillave drejtues të shkollave dhe do t'i informojë ata se si mund ta përmirësojnë shkollën me përfshirjen e komunitetit.
Menaxhimi i Shkollës	Drejtorët e shkollave	Ky kurs është i bazuar në Standardet e Praktikës Profesionale për drejtorët e shkollave të cilat janë zhvilluar nga ana e MASHT-it dhe Basic Education Program së bashku me donatorët e tjerë.
Menaxhimi i Qendrave për Ngritje Profesionale	Zyrtarët komunal	

Kurset që Basic Education Program i USAID-it është duke i marrë parasysh për të ardhmen, përfshijnë: përdorimin e TIK-ut në klasë, zhvillimin e faqeve të internetit.

SHTOJCA B:
REFERENCA DHE HULUMTIME TË MËTEJME

URL-të

<http://classroom.4teachers.org/>

<http://endeavorlc.blogspot.com>

<http://crunchychewymama.com>

<http://insideurbangreen.org>

<http://kidsrkidsrtp.com>

GIZ

KULTURKONTAKT

SWAp/MEST

USAID Basic Education Program

Shkolla Mileniumi i Tretë, Rr. Isa Kastrati pn, 10000, Prishtinë, Kosovë

www.bep-ks.org